Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika "b", dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror"", kreu III, neni 4, pika "a", "c", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3.5.2018, të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH", ka bërë "deklasifikimin e plotë" të dosjes së klasifikuar "sekret shtetëror", me vendimin nr. 5, datë 4.5.2018 si më poshtë:

1. Dosje përpunimi nr. 1721, për G. S., me 100 fletë. Niveli i klasifikimit "sekret", viti 1946-1987.
2. Dosje formulare nr. 5273, për V. SH., me 78 fletë. Niveli i klasifikimit "sekret", viti 1970-1981.
3. Dosje formulare nr. 388, kategoria 2B, për R. R., me 59 fletë, Niveli i klasifikimit "sekret", viti 1973-1983.

KRYETARE E KDZH-së
Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendimin nr. 6

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", të ndryshuar dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror"", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror", në AIDSSH, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara "sekret shtetëror", me vendimin nr. 6 datë 4.5.2018, si më poshtë:

1. Dosje formulare nr. 7921, për B. H., "sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1980-1989.
2. Dosje përpunimi nr. 11953, për I. D., "sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1984-1990.
3. Dosje përpunimi nr. 6621, për Z.Gj (J.L) "sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1978-1990.
4. Dosje përpunimi nr. 1758, për Z. L., "sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1978-1990.
5. Dosje operative për S. P., "sekret". Dokumentet e dosjeve datojnë në vitet 1974-1989.
6. Fashikulli i të arratisurit A. XH., nr. 1199, "tepër sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1977-1987.
7. Dosje përpunimi nr. 11652, për R. XH., "sekret". Dokumentet e dosjeve datojnë në vitet 1977-1989.
8. Dosje formulare nr. 165, për L. J., "tepër sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1967-1968.
9. Dosje formulare nr. 2941, për A. H., "tepër sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1971-1990.
10. Dosje përpunimi nr. 5830, për S. H., "sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1987-1988.

11. Dosje përpunimi nr. 585, për F. S., "sekret". Dokumentet e dosjeve datojnë në vitet 1975-1990.
12. Dosje formulare nr. 4955, për V. Z., "sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1960-1991.
13. Dosje formulare nr. 3428, për D. P., "sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1963-1987.
14. Dosje formulare nr. 1247, për A. F., "sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1953-1989.
15. 15. Dosje përpunimi nr. 1607, për B. Ç., "sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1976-1990.
16. Dosje përpunimi nr. 3206, për XH. S., "sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1983-1991.
17. Dosje përpunimi nr. 969, për G. R., "sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1983-1991.
18. 18. Fashikull nr. 6882, për R. S dhe V. S., me 23 fletë. Niveli i klasifikimit "sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1966-1990.
19. Dosje formulare nr. 936, për T. P., "tepër sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1959-1975.
20. Dosje formulare nr. 9, për J. C., "tepër sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1958-1960.
21. Dosje formulare nr. 665 (1241), për A. I., "tepër sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1964-1973.
22. Dosje formulare nr. 985 (2482), për A. S., "sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1962-1981.
23. Fotokopje e kartelës dhe fotokopje e fletës së regjistrit, ku figuron i regjistruar shtetasi D. A., me numër regjistri 13645.
24. Fotokopje e fletës së regjistrit ku figuron i regjistruar Y. Y. me numër regjistri 7802 dhe nr. 4190.

KRYETARE E KDZH-së
Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendimin nr. 7

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika "b", dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", kreu III, neni 4, pika "a", "c", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3.5.2018, të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH", ka bërë "deklasifikimin e plotë" të dosjes së klasifikuar "sekret shtetëror", me vendimin nr. 7, datë 4.5.2018 si më poshtë:

FONDI ARKIVOR I ISH-SIGURIMIT TË SHITETIT QË ADMINISTRUOHET NGA AIDSSH

1. Dosje e objektit të rëndësisë së veçantë (ORV), nr. 123, të Repartit të Riedukimit Spaç me dy fashikuj, 219 (dyqind e nëntëmbëdhjetë) dhe 23 (njëzet e tre) fletë, niveli i klasifikimit "tepër sekret".

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendimin nr. 8

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika "b", dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", kreu III, neni 4, pika "a", "c", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3.5.2018, të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH", ka bërë "deklasifikimin e plotë" të dosjes së klasifikuar "sekret shtetëror", me vendimin nr. 8 datë 5.6.2018 si më poshtë:

1. Dosje e problemit të centralizuar nr. 1079, me pseudonimin "Kubistët. Dosja ka 265 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret". Dosje agjenturore nr. 181, me pseudonimin "Kubistët". Dosja ka 123 (njëqind e njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
2. Dosje personale dhe pune nr. 12169, me pseudonimin "Pena", për L.Ç. Dosja ka 38 (tridhjetë e tetë) fletë, 25 (njëzet e pesë) fletë dhe 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
3. Fotokopje e fletës së regjistrit të përpunimeve model K.1 Tiranë, ku figuron i regjistruar F. L. me nr. regjistri 3204 në kategorinë 2A, me 1 (një) fletë.
4. Dosje formulare nr. 1001, në ngarkim të S. M., kategoria 2 A. Dosja ka 120 (njëqind e njëzet) fletë dhe fashikull për të dënuarin S.M. ka 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
5. Dosje personale dhe pune nr. 13854 e bashkëpunëtorit me pseudonimin "Motori" në ngarkim të A. A., me 19 (nëntëmbëdhjetë) dhe 21 (njëzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".

KRYETARE E KDZH-së
Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendimin nr. 9

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika "b", dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", kreu III, neni 4, pika "a", "c", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3.5.2018, të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH", ka bërë "deklasifikimin e plotë" të dosjes së klasifikuar "sekret shtetëror", me vendimin nr. 9, datë 5.6.2018, si më poshtë:

FONDI ARKIVOR I ISH-SIGURIMIT TË SHETIT QË ADMINISTROHET NGA AIDSSH

Dosje përpunimi nr. 758 në ngarkim të E. V., kategoria 2 B. Dosja ka 363 (treqind e gjashtëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".

1. Dosje përpunimi nr. 3078 në ngarkim të S.V., kategoria 2 B. Dosja ka 172 (njëqind e shtatëdhjetë e dy) fletë, dhe fashikull të dënuari me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
2. Dosje përpunimi nr. 3032 në ngarkim të Xh. B., kategoria 2 B. Dosja ka 112 (njëqind e dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
3. Dosje formulare nr. 2465 në ngarkim të P.D., kategoria 2 B. Dosja ka 86 (tetëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".

4. Dosje përpunimi nr. 2016 në ngarkim të L.S., kategoria 2 B. Dosja ka 112 (njëqind e dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
5. Dosje përpunimi nr. 2000 në ngarkim të A.G., kategoria 2 B. Dosja ka 114 (njëqind e katërbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
6. Dosje personale nr. 342, me pseudonimin “Gjoksi”, kategoria “agjent”, në ngarkim të B. B. Dosja personale ka 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë dhe 23 fotografi. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
7. Dosje personale nr. 343 me pseudonimin “Trimi”, kategoria “Agjent”, në ngarkim të S. H. Dosja personale ka 106 (njëqind e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
8. Dosje nr. 344, me pseudonimin “Gjoksi”, “Trimi”. Dosja ka 170 (njëqind e shtatëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
9. Dosje nr. 345, me pseudonimin “Gjoksi”, “Trimi”. Dosja ka 105 (njëqind e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
10. Dosje formularë nr. 271/1, në ngarkim të B. P., kategoria 2 A. Dosja ka 105 (njëqind e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
11. Dosje formulare nr. 968 (3692), në ngarkim të I. D, kategoria 2 B. Dosja ka 265 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

KRYETARE E KDZH-së
Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendimin nr. 10

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”, vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror””, kreu III, neni 4, pika “a”, “c”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3.5.2018, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 10, datë 19.6.2018 si më poshtë:

FONDI ARKIVOR I ISH-SIGURIMIT TË SHETIT QË ADMINISTRONET NGA AIDSSH

1. Dosje operative nr. 2695-A, në ngarkim të P. P. Dosja ka 179 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes i përkasin ish-Drejtorisë së Zbulimit Politik (Ana e Sigurimit). Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1957-1965.
 - Dosje operative pa numër në ngarkim të P. P. Dosja ka 172 (njëqind e shtatëdhjetë e dy) fletë dhe fashikull të arratisuri me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes i përkasin ish-Degës së Punëve të Brendshme Tiranë (ana e Sigurimit). Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1957-1983.
2. Fotokopje e kartelës model 2, me nr. 8926 në ngarkim të J. Sh., 1 (një) fletë.
 - Fotokopje e fletës së regjistrimit të agjenturës model K.1 Shkodër, ku figuron i regjistruar shtetasi J. Sh. me nr. regjistri 8926.

KRYETARE E KDZH-së
Gentiana Sula

RAPORTE TË AKTIVITETEVE TË AIDSSH-SË

Raport mbi platformën e komunikimit "Edhe muret kanë veshë", për ndërgjegjësimin ndaj krimeve të diktaturës komuniste në Shqipëri

Përgjatë gjithë natës së 8 majit, deri në agimin e datës 9, Ditës së Europës, në sheshet kryesore të gjashtë qyteteve: Tiranë, Shkodër, Berat, Korçë, Tepelenë e Gjirokastrë, u projektua njëkohësisht në të njëjtën orë instalacioni "Edhe muret kanë veshë", në kuadër të projektit "Përkujtojmë për të shëruar dhe parandaluar".

Në sheshet qendrore të qyteteve të mësipërme u ftuan të ndjekin instalacionin qytetarë, të rinj e studentë, përfaqësues të politikës dhe të trupit diplomatik, të institucioneve publike dhe joqeveritare, të artit, kulturës dhe medias.

Platforma e komunikimit "Edhe muret kanë veshë" kishte synim rritjen e ndërgjegjësimit mbi krimet e së shkuarës komuniste e inkurajimit të dialogut me universitetet, akademikët, komunitetet lokale, të mbijetuarit e krimeve të diktaturës komuniste, mediat dhe publikun e gjerë. Fushata kulmoi me një instalacion artistik dhe vijoi me përmbledhjen e historive personale të të mbijetuarve të krimeve të diktaturës ose të familjeve të tyre. Gjithashtu, këto dëshmi u vendos të pasqyrohen në të ardhmen edhe në një faqe interneti me të njëjtin emër; dëshmitë gojore do të filmohen në dokumentar, në mënyrë që njerëzit ta ndjekin rrugëtimin e këtij produkti artistik, t'i shohin fytyrat dhe t'i dëgjojnë historitë e shqiptarëve që qëndruan me dinjitet. Këto histori përbëjnë një databazë të rrëfimeve gojore që do të pasurohet në vijim dhe do t'i shtohen arkivit të Autoritetit.

Instalacioni, i realizuar nga artistja Alketa Xhafa-Mripa, është një krijim shumëdimensional i kujtesës kolektive për ata që u dënuan, humbën lirinë apo jetën në burgjet dhe kampet e diktaturës komuniste. Frazat apo thëniet që përshkruajnë tragjedinë njerëzore të shkaktuar nga krimet e komunizmit janë shkëputur nga dorëshkrime, dokumentime apo arkiva personale të individëve të burgosur apo të internuar dhe janë përzgjedhur nga dëshmitë gojore të të mbijetuarve. Me to Mripa krijoi një narrativë të zgjeruar, ku frazat lidhen me njëra-tjetrën, duke shfaqur aspekte të ndryshme të totalitarizmit. Shprehjet, dikur të ndaluara, u projektuan në formate të mëdha, në të njëjtën datë (8 maj 2018) dhe në të njëjtën kohë (ora 20.00) në fasadat kryesore të qyteteve, deri në agimin e Ditës së Europës, duke riafirmuar vlerat europiane, që ishin dhe vizioni i rrëfimitarëve.


Artistes iu bashkua një ekip ekspertësh të artit dhe të komunikimit, të cilët kontribuan në aktivitetet ndërgjegjësuese të kësaj platforme. Përmes artit, projekti synonte të njëjtte dhe t'i ffonte për reflektim

të rinjtë, komunitetet dhe publikun e gjerë me trashëgiminë e së shkuarës. “Është përballja me të vërtetën ajo që e çon shoqërinë drejt shërimit e që rivendos ekuilibra; rehabilitimi i viktimave, ridimensionimi i figurës së të pafajshmëve dhe nderimi i sakrificës së atyre që ia dolën me dinjitet njerëzor është hapi i madh që hedhim sot,” u shpreh Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

“Edhe muret kanë veshë” është vepër komplekse, e para e këtij lloji në Shqipëri për nga përmbajtja sociale dhe dimensionet instalative. Aktivitetet u organizuan në kuadër të projektit “Përkujtojmë për të shëruar dhe parandaluar”, zbatuar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me mbështetjen e PNUD Shqipëri dhe Qeverisë së Italisë. Instalacioni artistik u mbështet financiarisht edhe nga Ambasada Amerikane dhe Delegacioni i BE-së në Tiranë.

Programi ambicioz “Përkujtojmë, për të shëruar dhe parandaluar” përmbledh dy ndërhyrje kryesore: (i) konceptualizimin, historinë dhe praktikën e punës së detyruar gjatë regjimit komunist përmes një qasjeje historiko-juridike ndaj institucionalizimit të punës së detyruar. Kjo do të kontribuojë në konceptimin e vendeve të kujtesës, si Kampi i Tepelenës dhe (ii) fushatën e komunikimit “Edhe muret kanë veshë”, zbatuar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit me mbështetjen e PNUD-it në Shqipëri dhe Qeverisë së Italisë. Fushata u shtri në mbarë vendin, duke mbledhur dëshmi të të mbijetuarve të dënuar gjatë periudhës komuniste dhe dëshmi të solidaritetit që qytetarët e Tepelenës treguan ndaj viktimave.

Në këtë mënyrë, duke nxitur dialogun me komunitetet, duke zgjeruar hartën e dëshmimeve gojore të të mbijetuarve në mbarë vendin, duke konsoliduar bashkëpunimin me shkollat e universitetet, për të ndër-tuar një raport të shëndetshëm me të kaluarën, në mënyrë që ajo të shërbejë për reflektim e të mos përsëritet, Autoriteti jetëson misionin e vet ndërgjegjësues, demokratik dhe të edukimit qytetar.



Raport mbi ekspozitën e dokumenteve arkivore të repartit 303 të riedukimit Spaç në përkujtim të 45-vjetorit të Revoltës së Spaçit

Me rastin e 45-vjetorit të Revoltës së Spaçit, më 17 maj 2018 në Tiranë Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ekspozoi dokumente arkivore të të ashtuquajturit objekt i rëndësisë së veçantë, reparti 303 i riedukimit, Spaç. Aktiviteti ishte i hapur për mediat.

Materialet që dokumentuan revoltën, rezistencën dhe masat që e pasuan atë u ekspozuan në mjediset e Autoritetit, pranë Gardës së Republikës.

Materialet mbi Spaçin prej disa mijëra faqesh u vunë në dispozicion të të interesuarve, studiues dhe kërkues shkencorë, ish-të përndjekur dhe familjarë të tyre, shoqëri civile dhe media, duke mundësuar njohjen me inventarët e plotë të tyre. Të interesuarit mund të plotësonin formularët e kërkesës për informim, sipas ligjit nr. 45/2015 për t'i lexuar këto dokumente.

Revolta e Spaçit shpërtheu më 21 maj të vitit 1973 dhe u shtyp në mënyrë të dhunshme mëngjesin e datës 23 maj 1973. Materialet u ekspozuan deri më datë 25 maj 2018.



Raport mbi nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet AIDSSH dhe Projektit PERFORM mbi rolin e shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954)

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe projekti PERFORM - Shkenca Sociale Aktive dhe të Përgjegjshme bashkëpunuan në ndërtimin e një narrative mbi rolin e shkencës, elitave intelektuale dhe kërkimit shkencor në vitet e para të vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri.

Aktiviteti u zhvillua në Tiranë, më 18 maj 2018, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe ishte i hapur për mediat.

Znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit, shprehu rëndësinë e kësaj nisme, që merr përsipër të rishqyrtojë mbi baza profesionale figura e personalitete: “Duke analizuar me imtësi punën, kontributin e shkencëtarëve dhe raportet që krijoi sistemi me ta, studiuesit arrijnë të hedhin dritë mbi sfidat me të cilat ata u përballën”. Mbështetës i projekteve mbi kujtesën, z. Christoph Graf, Ambasador i Zvicrës në Shqipëri, përshëndeti aktivitetin dhe bashkëpunimin. “Qëllimi ynë kryesor është fuqizimi i komunitetit të shkencave sociale dhe mbështetja e iniciativave të ndërmarra nga grupet e studiuesve të këtyre shkencave me aktorët e tjerë në shoqëri, përfshirë sektorin publik, privat, shoqërinë civile dhe median”, thekson z. Martin Dietz i projektit PERFORM.

Personalitetet që u propozuan të studiohen në këtë kuadër, qasja shkencore dhe metodologjia u prezantuan nga znj. Sonila Boçi, historiane, drejtuese e grupit të studiuesve. Ata u ftuan të punojnë mbi figurat e: Gjergj Kokoshit, Eqrem Çabejt, Sabiha Kasimatit, Arshi Pipës, Odhise Paskalit, Aleks Budës, Ollga Plumbit, Petraq Pepos, Gjovalin Gjadrit dhe Petraq Qafokut. Qëllimi i projektit mbetet hulumtimi në pikëpamjen studimore i ndikimit të ish-Sigurimit të Shtetit, si arma më e fuqishme e ruajtjes së pushtetit të Partisë-Shtet, mbi shkencën dhe përfaqësuesit më në zë të saj.

Po ashtu, në studim do të tentohet që nëpërmjet hulumtimit në dosjet e Sigurimit të Shtetit të studiohen në mënyrë shkencore roli, mënyrat, diktimet, si edhe përndjekja e shkencëtarëve shqiptare, në gjithë fazat e jetës dhe punës së tyre.

Studimi i rolit të shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954) lidh punën kërkimore arkivore me misionin e Autoritetit për informimin e publikut dhe ruajtjen e kujtesës historike, për nisjen e një dialogu publik mbi këtë temë. Rezultati përfundimtar i bashkëpunimit do të jetë krijimi i një platforme interaktive komunikimi, e arritshme në mënyrë elektronike nga publiku i gjerë.

Ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes u zhvillua në mjediset e Akademisë së Shkencave, ditën e lindjes së titullarit të parë të Institutit të Shkencës, z. Selahudin Toto, deputet i dënuar nga regjimi komunist në 1947. Përkujtimi i këtij intelektual, që u prezantua nëpërmjet aktivitetit të tij kompleks, i hapi rrugën studimeve të hollësishme që kontribuojnë në lidhjen mes kërkimit shkencor dhe politikës, për kujtesën historike të Shqipërisë.



Raport mbi reagimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për emisionin "Aktualitet", në Shijak TV, të datës 24 maj 2018

Më 25 maj 2018 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit i përgjigjet aludimeve mbi punën e Autoritetit dhe transparencën me publikun, të bëra në emisionin "Aktualitet" në Shijak TV, të datës 24 maj 2018.

AIDSSH sqaron publikun në përgjithësi dhe kryesisht subjektet e ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish –Sigurimit të Shtetit" në veçanti, si më poshtë:

Që nga koha e konstituimit të tij e deri më sot, Autoriteti, në zbatim të ushtrimeve të detyrave funksionale, ka vijuar t'i ushtrorë në përputhje me ligjin organik 45/2015 dhe tërësinë e ligjeve të tjera që veprojnë në ushtrimin e punës së tij. Në çdo moment, Autoriteti është udhëhequr nga parimet e Kushtetutës, lidhur me transparencën dhe ligjshmërinë.

Pranë zyrave të AIDSSH-së është paraqitur z. Petrika Leka, në cilësinë e kërkuesit (i biri të ndjerit Genc Leka), i cili ka kërkuar shqyrtimin e dokumentacionit që ekziston dhe është përgatitur për z. Genc Leka nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit. Në këtë kontekst, z. Leka u njoh me dokumentacionin origjinal përkatës, dosje formulare dhe dosje hetimore-gjyqësore (dosjet e krijuara në ngarkim të shtetasit Genc Leka) dhe vlerësoi që ky dokumentacion t'i jepet i plotë.

Në aktivitetin përkujtimor të 40-vjetorit të pushkatimit të poetit Genc Leka, organizuar nga AIDSSH, të birit të poetit i janë dorëzuar kopje elektronike të dosjes formulare, në total 179 fletë, dhe dosje hetimore-gjyqësore, në total 1467 fletë, sipas procesverbalit të datës 17 korrik 2017, të nënshkruar nga vetë z. Petrika Leka.

Vlen të theksohet se e njëjta praktikë është ndjekur edhe me të bijën e poetit Vilson Blloshmi. Njohja dhe dorëzimi i dokumentacionit i është bërë trashëgimtares së tij ligjore, sipas të drejtës që i njeh ligji.

Sa i përket strukturës dhe organizimit të punës, çdo vit, lloji i pozicioneve për rekrutim dhe numri për çdo pozicion bëhet me vendim të Autoritetit, bazuar në relacionin përkatës të Sekretariatit Teknik. Si institucion i pavarur, ai bazohet në procedurat dhe detyrimet ligjore që rrjedhin kryesisht nga zbatimi i ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar si dhe akteve nënligjore përkatëse, si: vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.3.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese"; vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.3.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", si dhe aktet e tjera nënligjore dhe udhëzimet përkatëse të Departamentit të Administratës Publike (DAP).

I gjithë procesi i rekrutimit bëhet i hapur dhe transparent, nëpërmjet publikimit të njoftimeve/procedurave përkatëse (për institucionet e pavarura), në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, faqen zyrtare të AIDSSH-së dhe stendat e informimit të publikut. Bazuar në rezultatet përfundimtare të procesit të rekrutimit, në bashkëpunim me ASPA-n (Shkollën Shqiptare të Administratës Publike) dhe kalendarin e tyre vjetor, organizohen trajnime të detyrueshme për punonjësit në provë (jo me statusin e nëpunësit civil) apo trajni

me të nevojshme, në përputhje me nevojat dhe kërkesat e vendit të punës për pjesën tjetër.

Për të arritur në finalizimin e një dokumenti strategjik që përcakton punën e Autoritetit gjatë këtij mandati, në datat 12-13 prill të vitit 2017 u organizuan takime pune me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë të OSBE-së, PNUD-it dhe ambasadorëve të Zvicrës, Gjermanisë e Bullgarisë në Tiranë, drejtuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Institutit të Studimeve Politike, Institutit të Historisë, Fakultetit të Drejtësisë, Shërbimit Informativ Shqiptar, gazetarëve dhe stafit të Autoritetit. Përgjatë seminarit u diskutuan dhe u trajtuan sfidat që përfshijn mbledhja dhe përpunimi i arkivit të ish-Sigurimit, asgjësimi ose mungesa e dokumentacionit shoqëruar, manipulimi i arkivave, krahasuar me praktikën e institucioneve europiane, si ndihmë për AIDSSH në procesin e pasqyrit me vërtetësi të së shkuarës së shoqërisë shqiptare dhe metodave që përdorin institucionet homologe në vende të ndryshme të Europës.

Takimi dyditor përfundoi me përgatitjen e një dokumenti strategjik dhe nënshkrimin e tij për vënien

në zbatim të punës së Autoritetit për një periudhë 4-vjeçare. Ai shërbeu për prezantimin e punës së institucionit të ri të pavarur. Ky informacion është përfshirë në raportin vjetor të punës 2017, paraqitur Kuvendit të Shqipërisë.

Raport mbi marrëveshjen e bashkëpunimit midis Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Institutit të Historisë "Ali Hadri" Prishtinë

Më 29 maj 2018, në mjediset e AIDSSH-së, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Institutit të Historisë "Ali Hadri" Prishtinë, mes znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit dhe z. Gjon Berisha, Drejtor i Institutit, në prani të historianëve, studiuesve dhe kërkuesve shkencorë.

Objekt i marrëveshjes u vendos institucionalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit të ndërsjellë, për mbështetjen e kërkimit shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së Sigurimit. "Sot konkretizohet një projekt i ri mes AIDSSH-së dhe komunitetit të historianëve në Kosovë e Shqipëri, "Kosova në dokumentet sekrete '44-'90", bashkëpunim që do të zgjasë në kohë, me kontributin e studiuesve më të përgatitur dhe në kushtet e ruajtjes së të dhënave personale e interesit kombëtar", u shpreh për të pranishmit kryetarja e Autoritetit, znj. Sula. "Të dyja institucionet do të bashkërendojnë punën për kryerjen e studimeve shkencore në materialet arkivore, mbi rolin dhe funksionimin e ish-Sigurimit të Shtetit në shtet dhe shoqëri, gjatë periudhës 29 nëntor 1944-2 korrik 1991; do të ndërtojnë bashkërisht projekte studimore e botuese, si dhe do të kryejnë hulumtime në arkivat shqiptare e të huaja për këtë periudhë".

"Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje kemi mundësi të hedhim dritë mbi ngjarje dhe personazhe historike, bazuar në dokumentet e panjohura që gjenden në arkivin e ish-Sigurimit të Shtetit. Po ashtu, kjo është mundësi shumë e mirë që risitë të integrohen në "Historinë e Kosovës", theksoi në fjalën e vet z. Gjon Berisha, Drejtor i Institutit të Prishtinës.

Z. Sabit Syla, kërkues shkencor, bartës i projektit "Historia e Kosovës", vuri në dukje se "marrëveshja do të na ndihmojë shumë në kohën kur po përgatitet edicioni 4-vëllimësh i "Historisë së Kosovës", si pjesë e historisë kombëtare e më tej, asaj rajonale. Në veçanti, do t'i ndihmojë historianët për zbardhjen e qëndrimeve zyrtare të Shqipërisë dhe ish-Jugosllavisë gjatë sistemit komunist".

Duke vlerësuar nënshkrimin e marrëveshjeve të tilla të bashkëpunimit, znj. Sonila Boçi, përfaqësuese e Institutit të Historisë në Akademinë e Studimeve Albanologjike, nënvizoi se këto nisma e zgjerojnë rrjetin e studiuesve dhe krijojnë premisat për t'i shkuar historisë në thellësi.

Autoriteti dhe Instituti i Historisë së Prishtinës vendosën të bashkëpunojnë për hartimin e planeve të përbashkëta vjetore të aktiviteteve për edukimin qytetar, konferencave, takimeve të punës, etj. Veprimtaria e përbashkët kërkimore-shkencore do të realizohet në kuadër të nismave rajonale, ballkanike, europiane dhe botërore, ku institucionet vënë në dispozicion të njëri-tjetrit botime, publikime, studime që kanë të bëjnë me veprimtarinë dhe funksionimin e ish-Sigurimit të Shtetit, në përputhje me kriterin e rëndësisë historike kombëtare. Ky bashkëpunim synon të konsolidojë njohjen e së shkuarës mbi baza shkencore, në funksion të transparencës dhe komunikimit profesional me opinionin publik.



Raport mbi ekspozimin e dokumenteve arkivore të rezistencës antikomuniste në jug të vendit-persekutimi komunist në zonën e Konispolit

Më 19 qershor 2018 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe Bashkinë Konispol, ekspozoi materiale arkivore të dhjetëra dosjeve të përndjekjes së Sigurimit ndaj faktorit antikomunist në jugun e vendit, shumë prej të cilave për herë të parë.

Materialet mbi personalitete të kohës, si Teme Sejko, Tahir Demi, Rexhep Plaku e dhjetëra të tjerë përbëjnë disa mijëra faqe dhe u vunë në dispozicion të të interesuarve, studiues dhe kërkues shkencorë, ish-të përndjekur dhe familjarë të tyre, shoqëri civile dhe media, duke mundësuar njohjen me inventarët e plotë të tyre dhe më gjerë. Të dhënat që dokumentojnë goditjen e përqendruar, përndjekjen, rezistencën dhe masat që e pasuan atë u ekspozuan në mjediset e Autoritetit, pranë Gardës së Republikës. Në kuadër të kësaj veprimtarie, AIDSSH ka kryer kërkim të thelluar mbi viktimat e zonës gjatë viteve 1946-1973, në dokumente dhe mikrofilma. Mbi bazën e tyre u verifikuan të dhëna mbi akuzat, vitin e arrestimit, vitin e dënimit dhe formën e dënimit. Në total u verifikuan 40 dosje të natyrës formularë, hetimore-gjyqësore dhe bashkëpunëtori, për 46 viktima të evidentuara. Të gjitha materialet e sipërpërmendura janë të deklasifikuara. Për t'u njohur me to, të interesuarit mund të plotësojnë formularët e kërkesës për informim, sipas ligjit nr. 45/2015 për t'i lexuar këto dokumente.

Veç dosjeve të deklasifikuara, dokumenteve dhe fotove arkivore që u shfaqën për herë të parë, bashkëpunimi me Arkivin Qendror Shtetëror mundësoi korrespondencën e një pjese të të dënuarve me Komitetin Qendror të PPSH-së, ku hidhet dritë në aspektet që çuan në dënimin e tyre. Gjithashtu u ekspozuan edhe "letra të popullit" në mbështetje të dënimit të grupit të Teme Sejkos.

Materialet mbetën të ekspozuara deri në datën 22 qershor 2018.

Ceremonia u hap dhe u moderua nga z. Altin Hoxha, anëtar i Autoritetit, i cili u shpreh se "janë qindra dosje, disa dhjetëra mijëra dokumente, qindra mikrofilma, që pasqyrojnë intrigat e ish-Sigurimit të Shtetit dhe të gjithë makinerisë totalitare që regjimi komunist ndërmori ndaj më shumë se 150 personave dhe familjarëve të tyre në zonën e Konispolit, ndaj të ashtuquajturit "grupi armiqësor çam". Janë këto dokumente që evidentojnë viktimat, të ekzekutuarit, torturat në burgjet komuniste, mbi 1500 vite burg dhe dhjetëra familje të internuara".

Kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula, e mbështeti fjalën e saj në parimet e ENSR-së, Rrjetit Europian të Kujtesës, parime që e vënë memorien historike në themel të identitetit dhe trashëgimisë së individëve e bashkësive, si: paraqitja e këndvështrimeve të ndryshme; evitimi i shprehjeve deterministe; evitimi i përgjithësimeve; trajtimi i figurave historike si individë, duke u qëndruar larg stereotipizimeve, sigurimi i një baze gjuene historike; përdorimi i njohurive të nivelit akademik si burime, ku gjatë punës, çdo përmbajtje duhet të ballafaqohet e të diskutohet me akademikë të njohur dhe të certifikuar për njohuritë specifike dhe njohuritë e duhura për këtë punë.

Kryetari i Bashkisë së Konispolit, z. Shuaip Beqiri, falënderoi për nismën institucionale të ndërmarrë për rivlerësimin e figurave dhe paqtimin e komunitetit, i cili prej vitesh ka qenë dhe është ndier i përbaltur.

Si përfaqësues i shoqatës "Çamëria", mes të pranishmëve të shumtë, familjarë, studiues, përfaqësues të institucioneve publike dhe ndërkombëtare, organizatave joqeveritare dhe shoqërisë civile, z. Shpëtim Idrizi çmoi hedhjen dritë mbi të vërtetën, duke vënë në dukje se persekutimi i dhjetëra familjeve çame në breznitë të tëra, i programuar dhe sistematik, është tragjedia e dytë që përjetoi ky komunitet pas asaj të vitit 1913, por kësaj here, në vendin e vet. Shoqata "Çamëria" vlerësoi me mirënjohje kryetaren e AIDSSH-së për punën e bërë në kuadër të rishqyrtimit historik të dokumenteve të kësaj bashkësie. Në fund të takimit e morën fjalën trashëgimtarë të personaliteteve të martirizuar, të përndjekur për vite me radhë si familjarë të kundërshtarëve të regjimit. Rezistenca dhe dinjiteti njerëzor i përcjellë nga fjalët e Agim Plakut, djalit të Rexho Plakut dhe Sanije e Nesibe Plakut, vajzave të Beqo Plakut të pushkatuar, ishin mbresëlënëse dhe flisnin më shumë se çdo retorikë shoqërisë së sotme, e cila mund të mbështetet në fibrën morale të njerëzve të ndershëm.

Ekspozita e zhvilluar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe Bashkinë Konispol hapi siparin e aktiviteteve kushtuar përkujtimin të figurave të shumëdiskutuara, që u mbajt në Konispol,

më 26 qershor, me praninë e komunitetit vendas. Veprimtari të tilla të AIDSSH-ja ka planifikuar të shtrijë në të gjithë vendin, duke inkurajuar dialogun lokal mbi të shkuarën dhe duke vënë në fokus ngjarje të zonave përkatëse, të cilat shërbejnë për të ridimensionuar figurat dhe për të nxitur reflektim.

Goditja e elementit me kontribute antifashiste në jug të vendit nisi që në vitin 1946, me dënimin e Rexhep Plakut, themelues i batalionit "Çamëria" dhe vijoi në mënyrë të përshkallëzuar me dënimin e admiral Teme Sejkos dhe "grupit të tij" në 1961, që legjitimoi prishjen e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik. Deri në vitin 1973, terrori u shtri në dhjetëra emra e familjet e tyre, duke e shenjuar për disa breza fatin e një bashkësie të tërë.



Raport mbi dialogun me komunitetin vendas në kuadër të ekspozitës arkivore të rezistencës antikomuniste në jug të vendit në lidhje me persekutimin komunist në zonën e Konispolit

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim dhe Bashkinë Konispol dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, më 26 qershor 2018 organizoi një dialog të hapur publik në qytetin e Konispolit mbi rezistencën antikomuniste në këtë zonë. Aktiviteti ishte i hapur për mediat.

Ky takim pasoi ekspozitën me materiale arkivore të dhjetëra dosjeve të përndjekjes së Sigurimit ndaj figurave të mirënjohura në jug të vendit, i mbajtur më 19 qershor në mjediset e AIDSSH-së në Tiranë.

Ekspozita e zhvilluar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe Bashkinë e Konispolit u zhvendos në Konispol, pranë komunitetin vendas, me qasje europiane ndaj së shkuarës. Dialogu lokal u fokusua në ngjarjet specifike të zonave përkatëse, për të ridimensionuar figurat njerëzore dhe për të nxitur reflektim.

Materialet mbi personalitete të kohës, si Teme Sejko, Tahir Demi, Rexhep Plaku e dhjetëra të tjerë që shkojnë në disa mijëra faqe u vunë në dispozicion të të interesuarve të kësaj bashkësie, ish-të përndjekur e familjarë të tyre, si dhe studiues e kërkues shkencorë, shoqëri civile dhe media, duke mundësuar njohjen me inventarët e plotë dhe më gjerë.

Në kuadër të kësaj veprimtarie, AIDSSH ka kryer kërkim të thelluar mbi viktimat e zonës gjatë viteve 1946-1973, në dokumente dhe mikrofilma. Mbi bazën e tyre u verifikuan të dhëna mbi akuzat, vitin e arrestimit, vitin e dënimit dhe formën e dënimit. Në total u verifikuan 40 dosje të natyrës formularë, hetimore-gjyqësore dhe bashkëpunëtori, për 46 viktimat të evidentuara. Të gjitha materialet e sipërpërmendura u deklasifikuan. Me plotësimin e formularëve e kërkesës për informim, të interesuarit sipas ligjit nr. 45/2015 mund të njihen me këto dokumente.

Takimi i moderuar nga z. Altin Hoxha, anëtar i Autoritetit u hap nga kryetari i Bashkisë së Konispolit, z. Shuaip Beqiri, dhe vijoi me fjalën e z. Ardit Bido, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Mbi figurën e Rexho Plakut dhe persekutimin komunist në këndvështrimin e historianit të zonës folën

znj. Sonila Boçi e AKA dhe z. Halil Shabani. Në fund të takimit, familjarë të të dënuarve dhe të rinj të zonës morën fjalën dhe interpretuan pjesë të Bilal Xhaferrit apo mbi përndjekjen dhe triumfin e dinjitetit njerëzor. Takimi i AIDSSH-së në Konispol hapi siparin e aktiviteteve përkujtimore në mbarë vendin dhe synon inkurajimin e dialogut lokal në përballje me të shkuarën, në funksion të reflektimit dhe edukimit qytetar.

Goditja e elementit me kontribute antifashiste në jug të vendit nisi që në vitin 1946, me dënimin e Rexhep Plakut, themelues i batalionit "Çamëria" dhe vijoi në mënyrë të përshkallëzuar me dënimin e admiral Teme Sejkos dhe "grupit të tij" në 1961. Deri në vitin 1973, terrori u shtri në dhjetëra emra e familjet e tyre, duke e shënjuar për disa breza fatin e një bashkësie të tërë.



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Adresa
Garda e Republikës, Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë
www.autoritetidosjeve.gov.al



PËR VITIN
2018 | **Nr. 4**
(korrik - gusht 2018)

BULETINI

I VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT
PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Të gjitha publikimet e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit mund të gjenden në versionin online, në faqen zyrtare të institucionit www.autoritidosjeve.gov.al dhe në platformën ISSUU <https://issuu.com/aidssh>

Buletinët botohen në përputhje në ligjin nr. 45/2015, ***“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”***, ligjin nr. 9887/2008, ***“Për mbrojtjen e të dhënave personale”***, i ndryshuar dhe ***“Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në AIDSSH”***, miratuar me vendimin nr. 25, datë 25/05/2017 dhe ***“Rregulloren mbi publikimin e veprimtarisë së Autoritetit, në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, përmes buletinit në letër apo online në faqen e Autoritetit”***, miratuar me vendimin nr. 88, datë 22/2/2019 të Autoritetit.

Nëse jeni të interesuar për informacion të mëtejshëm, mund të paraqitni kërkesë të posaçme pranë AIDSSH-së, në përputhje me ligjin nr. 45/2015, ***“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*** dhe ligjin nr. 119/2014 ***“Për të drejtën e informimit”***.

BULETINI

I VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT
PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR VITIN
2018

PËRMBAJTJA

Vendime mbi bazën e kërkesave të institucioneve kushtetuese dhe atyre publike..... 8

Vendim nr. 219, datë 13.7.2018 (i shkurtuar)	9
Vendim nr. 220, datë 17.7.2018 (i shkurtuar)	9
Vendim nr. 228, datë 27.7.2018 (i shkurtuar)	10
Vendim nr. 256, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	10
Vendim nr. 257, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	10
Vendim nr. 222, datë 20.7.2018 (i shkurtuar)	11

Vendime për bashkëpunimin me institucione kushtetuese 12

Vendim nr. 218, datë 13.7.2018 (i shkurtuar)	13
--	----

Vendime për informim për qëllime kërkimore, historike nga studiues, media 14

Vendim nr. 202, datë 3.7.2018 (i shkurtuar)	15
Vendim nr. 203, datë 3.7.2018 (i shkurtuar)	15
Vendim nr. 204, datë 3.7.2018 (i shkurtuar)	15
Vendim nr. 205, datë 3.7.2018 (i shkurtuar)	16
Vendim nr. 214, datë 10.7.2018 (i shkurtuar)	16
Vendim nr. 215, datë 10.7.2018 (i shkurtuar)	16
Vendim nr. 217, datë 10.7.2018 (i shkurtuar)	17
Vendim nr. 247, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	17
Vendim nr. 248, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	18
Vendim nr. 250, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	18
Vendim nr. 253, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	18

Vendime të organizimit të brendshëm të Autoritetit.....20

Vendim nr. 254, datë 6.8.2018 (i shkurtuar)	21
Vendim nr. 255, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	21

Vendime për persona të prekur, palë të treta, të afërm të të vdekurve apo të zhdukurve, bashkëpunëtorëve apo të favorizuarve nga ish-Sigurimi i Shtetit	22
Vendim nr. 206, datë 3.7.2018 (i shkurtuar)	23
Vendim nr. 207, datë 3.7.2018 (i shkurtuar)	23
Vendim nr. 208, datë 3.7.2018 (i shkurtuar)	24
Vendim nr. 209, datë 3.7.2018 (i shkurtuar)	24
Vendim nr. 210, datë 3.7.2018 (i shkurtuar)	24
Vendim nr. 211, datë 3.7.2018 (i shkurtuar).....	25
Vendim nr. 212, datë 6.7.2018 (i shkurtuar)	25
Vendim nr. 213, datë 10.7.2018 (i shkurtuar)	26
Vendim nr. 216, datë 10.7.2018 (i shkurtuar)	26
Vendim nr. 221, datë 17.7.2018 (i shkurtuar)	27
Vendim nr. 223, datë 20.7.2018 (i shkurtuar)	27
Vendim nr. 224 , datë 20.7.2018 (i shkurtuar)	28
Vendim nr. 225, datë 20.7.2018 (i shkurtuar)	28
Vendim nr. 226, datë 20.7.2018 (i shkurtuar)	28
Vendim nr. 227, datë 20.7.2018 (i shkurtuar)	29
Vendim nr. 229, datë 27.7.2018 (i shkurtuar)	29
Vendim nr. 230, datë 27.7.2018 (i shkurtuar)	29
Vendim nr. 231, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	30
Vendim nr. 232, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	30
Vendim nr. 233, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	31
Vendim nr. 234, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	31
Vendim nr. 235, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	31
Vendim nr. 236, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	32
Vendim nr. 237, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	32
Vendim nr. 238, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	32
Vendim nr. 239, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	33
Vendim nr. 240, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	33
Vendim nr. 241, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	34
Vendim nr. 242, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	34
Vendim nr. 243, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	35
Vendim nr. 244, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	35
Vendim nr. 245, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	36
Vendim nr. 246, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	36
Vendim nr. 249, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	37
Vendim nr. 251, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	37
Vendim nr. 252, datë 1.8.2018 (i shkurtuar)	37
Vendim nr. 258, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	38
Vendim nr. 259, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	38
Vendim nr. 260, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	39

Vendim nr. 261, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	39
Vendim nr. 262, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	40
Vendim nr. 263, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	40
Vendim nr. 264, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	41
Vendim nr. 265, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	41
Vendim nr. 266, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	41
Vendim nr. 267, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	42
Vendim nr. 268, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	42
Vendim nr. 269, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	43
Vendim nr. 270, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	43
Vendim nr. 271, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	44
Vendim nr. 272, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	44
Vendim nr. 273, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	44
Vendim nr. 274, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	45
Vendim nr. 275, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	45
Vendim nr. 276, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	45
Vendim nr. 277, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)	46

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH 48

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendimin nr. 11	48
Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendimin nr. 12.....	51
Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendimin nr. 13.....	51
Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendimin nr. 14.....	52

Raporte të aktiviteteve të AIDSSH-së 54

Raport mbi veprimtarinë e ekspozimit të dokumenteve arkivore të rezistencës antikomuniste dhe përndjekjes së Sigurimit për zonën e Tepelenës	54
Raport mbi Ditën Muzeale/Memoriali Tepelenë.....	55
Raport mbi prezantimin e aplikacionit për gjetjen e të zhdukurve	57

**VENDIME
MBI BAZËN E
KËRKESAVE TË
INSTITUCIONEVE
KUSHTETUESE
DHE ATYRE
PUBLIKE**



Vendim nr. 219, datë 13.7.2018 (i shkurtuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015, datë 30.4.2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", ligjit nr. 105/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", në mbledhjen e datës 13.7.2018 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të informojë Kryeministrinë, për informacionin që kërkohet nr. 914/1 prot., datë 3.7.2018, e përditësuar me shkresën nr. 914/3 prot., datë 12.7.2018, lidhur me procesin e verifikimit të cilëve etike, morale dhe profesionale të kandidatëve që kanë aplikuar, për pozicionin e gjyqtarit të Shqipërisë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut se:
 - a). Për znj. M. S., z. S. B. dhe z. D. P., që kanë aplikuar për pozicionin e gjyqtarit të Shqipërisë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nga verifikimet e kryera deri tani, **nuk figuron të ketë materiale**, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në emër të tyre, sipas nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: **Gentiana Sula**
Anëtarë: **Altin Hoxha, dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj**

Vendim nr. 220, datë 17.7.2018 (i shkurtuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015, datë 30.4.2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", në mbledhjen e datës 17.7.2018 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të informojë Departamentin e Administratës Publike për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 4043/1 prot., datë 11.6.2018, lidhur me vlerësimin e cilësive etike, morale dhe profesionale të anëtarit të trupës së nivelit të lartë drejtues në administratën shtetërore dhe pozicione të barazvlefshme me to, se:
 - a) Për znj. M. M., nga verifikimet e kryera deri tani, **nuk figuron të ketë materiale** në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas nenit 29, pika 2, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: **Gentiana Sula**
Anëtarë: **Altin Hoxha, dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj**

Vendim nr. 228, datë 27.7.2018 (i shkurtuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015, datë 30.4.2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", në mbledhjen e datës 27.7.2018 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të informojë Ministrinë e Shtetit për Diasporën për informacionin që kërkohet me shkresën 3248/1 prot., datë 13.7.2018, lidhur me vlerësimin e cilësive etike, morale dhe profesionale të Drejtores së Kabinetit të Ministrit të Shtetit për Diasporën, se:
 - a) Për znj. E. H., nga verifikimet e kryera deri tani, **nuk figuron të ketë materiale** në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas nenit 29, pika 2, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: **Gentiana Sula**
Anëtarë: **Altin Hoxha, dr. Marenglen Kasmi**

Vendim nr. 256, datë 29.8.2018 (i shkurtuar)

32. Dosje formulare nr. 3862 në ngarkim të S. Y. K., kategoria 2 A. Dosja ka 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
33. Dosje formulare nr. 4277 në ngarkim të N. S. B.(D) mbi bandat. Dosja ka 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
34. Dosje formulare nr. 4377 në ngarkim të Z. H., kategoria 2 B. Dosja ka 104 (njëqind e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
35. Dosje formulare nr. 5 në ngarkim të N. J. G., kategoria 2 A. Dosja ka 108 (njëqind e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
36. Dosje formulare nr.33 në ngarkim të B. A. N. Dosja ka 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë.
37. Fotokopje dokumentesh në ngarkim të P. Gj. P.
 - Fotokopje e kartelës model 2, nr. 2447, kategoria “S”, pseudonimi “Pejsazhi” drejtimi “Grupet kundërrevolucionare”, me 1 (një) fletë.
 - Urdhër për asgjësimin e dokumenteve nr. 01-7, datë 18.2.1991, me 1 (një) fletë.
 - Procesverbali nr. 3, datë 20.3.1991 i Degës Punëve të Brendshme Lezhë “Për asgjësimin me djegie të dokumenteve që pasqyrohen në listën e veçimit nr. 2/1, datë 20.3.1991”, me 1 (një) fletë

KRYETARE E KDZH-së
Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendimin nr. 17, datë 19.9.2018

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”, dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika “a”, “c”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 3.5.2018, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë “deklasifikimin e plotë” të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 17, datë 17.10. 2018, si më poshtë:

FONDI ARKIVOR I ISH-SIGURIMIT TË SHETIT QË ADMINISTRUOHET NGA AIDSSH

1. Fotokopje dokumentesh në ngarkim të Q.P.
 - Fotokopje e regjistrit të agjunkturës të degës IV, model K.I (1 fletë).
2. Fotokopje dokumentesh në ngarkim të Z.K.
 - Fotokopje e regjistrit të agjunkturës Tropojë (1 fletë).
3. Fotokopje dokumentesh në ngarkim të Dh. S.
 - Fotokopje e fletës së regjistrit të agjunkturës Model K.I, Tiranë me nr.67.(1 fletë).
 - Vendimi nr. 110/42, datë 9.10.1990, për heqjen nga RSI dhe vendim për asgjësim të dosjes personale të BP “STUDJUESI”(2 fletë).

KRYETARE E KDZH-së
Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendimin nr. 18, datë 19.9.2018

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika "b", dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", kreu III, neni 4, pika "a", "c", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 3.5.2018, të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH", ka bërë "deklasifikimin e plotë" të dosjeve të klasifikuara "sekret shtetëror", me vendimin nr. 18, datë 22.11.2018, si më poshtë:

FONDI ARKIVOR I ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT QË ADMINISTRUHET NGA AIDSSH-JA

1. Dosje përpunimi nr. 861, në ngarkim të N. P., kategoria 2B. Dosja ka 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes ishte "tepër sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1958-1982.
2. Dosje përpunimi nr. 679, kategoria 2B, në ngarkim të M. V., me 230 (dyqind e tridhjetë) fletë, një kartelë + 4 fletë në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
3. Dosje formulare nr. 8051, kategoria 2B, në ngarkim të N. V., me 26 (njëzet e gjashtë) fletë dhe një kartelë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
4. Dosje formulare nr. 10489, kategoria 2B, në ngarkim të H. G., me 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) fletë dhe një kartelë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1982-1990.
5. Dosje përpunimi nr. 1344, kategoria 2A, në ngarkim të I. S., me 242 (dyqind e dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
6. Dosje përpunimi nr. 1796, kategoria 2B, në ngarkim të Gj. M., me 43 (dyzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
7. Dosje formulare nr. 1466, kategoria 2A, në ngarkim të Xh. K., me 34 (tridhjetë katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
8. Dosje përpunimi nr. 1573, kategoria 2B, në ngarkim të H. Gj., me 228 (dyqind e njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
9. Dosje përpunimi nr. 679, kategoria 2B, në ngarkim të Sh. Gj., me 159 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
10. Dosje formulare nr. 9342-H (35934), kategoria 2A, në ngarkim të Ch. J., me 92 (nëntëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
11. Dosje formulare nr. 6435-H (35825), kategoria 2A, në ngarkim të A. J., me 335 (treqind e tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
12. Dosje përpunimi nr. 2495, kategoria 2B, në ngarkim të K. Gj., me 95 (nëntëdhjetë e pesë) fletë dhe fletët në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
13. Dosje kërkimi e të arraturit me numër 2339, kategoria 2A, në ngarkim të Th. Gj., me 39 (tridhjetë e nëntë) fletë dhe zarf me korrespondenca. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
14. Dosje për thyesin e kufirit, me numër 5634, në ngarkim të R. K., me 34 (tridhjetë e katër) fletë dhe zarf me korrespondenca. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
15. Dosje përpunimi nr. 2318, kategoria 2B, në ngarkim të D. M., me 72 (shtatëdhjetë e dy) fletë dhe 1 kartelë model 1. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1978-1990.
16. Dosje përpunimi nr. 1025, kategoria 2B, në ngarkim të D. D., me 161 (njëqind e gjashtëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
17. Dosje formulare nr. 265, kategoria 2B, në ngarkim të A. M. (U), me 125 (njëqind e njëzet

- e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
18. Dosje përpunimi nr. 98, kategoria 2A, në ngarkim të B. H., me 333 (treqind e tridhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
 19. Dosje formulare nr. 366, kategoria 2B, në ngarkim të T. A., me 192 (njëqind e nëntëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
 20. Dosje përpunimi nr. 4182, kategoria 2A, në ngarkim të Sh. Rr, me 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
 21. Dosje përpunimi nr. 12429, kategoria 2A, në ngarkim të G. L., me 70 (shtatëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
 22. Dosje përpunimi nr. 5283, kategoria 2A, në ngarkim të Xh. N., me 404 (katërqind e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
 23. Dosje formulare nr. 2081, kategoria 2A, në ngarkim të I. P. me 173 (njëqind e shtatëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
 24. Dosje formulare nr. 634, kategoria 2A, në ngarkim të H. D., me 75 (shtatëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
 25. Dosje formulare nr. 171, kategoria 2A, në ngarkim të A. D., me 117 (njëqind e shtatëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
 26. Dosje formulare nr. 298, kategoria 2A, në ngarkim të Sh. K., me 147 (njëqind e dyzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
 27. Dosje drejtimi për I. K. R., nr. 9, kategoria 2A dhe 2B. Dosja përbëhet nga dy volume me gjithsej 644 (gjashtëqind e dyzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
 28. Dosje me fashikuj për I. K. R., nr. 1318, kategoria 2A dhe 2B. Dosja ka gjithsej 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
 29. Dosje objekti nr. 733, kategoria 2B, në ngarkim të “K. Sh. L” N. Y. Dosja ka gjithsej 732 (shtatëqind e tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
 30. Dosje përpunimi nr. 214, kategoria 2A, në ngarkim të R. K. me dy volume, me gjithsej 656 (gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Ka dosje formulare nr. 2469/2 me 10 fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
 31. Dosje formulare nr. 298, kategoria 2A, në ngarkim të Sh. K, me 147 (njëqind e dyzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
 32. Dosje formulare nr. 2823, kategoria 2B, në ngarkim të S. L., me 233 (dyqind e tridhjetë e tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
 33. Dosje formulare nr. 1840, kategoria 2A, në ngarkim të E. D. me 231 (dyqind e tridhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

RAPORTE TË AKTIVITETEVE TË AIDSSH-SË

Raport mbi ekspozimin e dokumenteve arkivore të rezistencës antikomuniste të kryengritjes së Zhapokikës, në përkujtim të 70-vjetorit të kryengritjes së Zhapokikës

Më 5 tetor 2018, në mjediset e Akademisë së Shkencave u zhvillua aktiviteti përkujtimor për 70-vjetorin e kryengritjes së Zhapokikës. Një ditë më vonë, më 6 tetor, aktiviteti u zhvendos në Memaliaj, duke përkujtuar kryengritjen në mjedisin ku ai mori jetë. Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në funksion të veprimtarisë dhe hulumtimit shkencor, me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit dhe edukimit qytetar, jep informacione dhe ekspozon materiale arkivore të dosjeve të rezistencës antikomuniste.

Me pjesëmarrjen e z. Simon Mirakaj dhe z. Altin Hoxha, anëtarë, AIDSSH vuri në dispozicion të publikut materialet e veta arkivore, duke krijuar mundësi për t'u njohur dhe thelluar me informacione, dokumente, procesverbale, dosje, foto e statistika që plotësojnë tablonë historike të kryengritjes së Zhapokikës, e cilësuar si një nga aksionet më të forta të rezistencës sonë kombëtare antikomuniste; duke hedhur dritë mbi të shkuarën, me baza profesionale, transparencë dhe komunikim të hapur me publikun.

Kryengritja antikomuniste

Kryengritja e vitit 1948 u zhvillua në Zhapokikë, një fshat i Memaliajt në rrethin e Tepelenës, dhe konsiderohet si një ndër ngjarjet që lanë gjurmë në historinë e Shqipërisë të pas Luftës së Dytë Botërore. Masat shtrënguese në rrafshin politik dhe ekonomik të qeverisë komuniste ndaj të gjitha shtresave shoqërore të popullatës shkaktuan kudo pakënaqësi e zemëratë. Shkatërrimi i bazës ekonomike në fshat, tatimet e rënda, marrja e tokës, e bagëtive, por sidomos përmdjekja e egër për shkaqe politike e individëve të përfshirë në formacionet luftarake nacionaliste gjatë viteve të Luftës, si dhe familjeve të tyre, solli reagimin e fshatarëve ndaj pushtetit të ri.

Nismëtari i krijimit të çetës, Xhemal Brahimi, ishte aktivizuar në luftën antifashiste në radhët e Ballit Kombëtar. Ai mbante kontakte me fshatrat e Tepelenës, si Zhapokika, Luftinja, Kamçishti, Salaria, Plashniku, Levani, Gllava, etj. Agjitacioni që zhvillonte Xhemali me fshatarët kishte të bënte me gjendjen e tyre të keqe, përkrahjen e antikomunistëve nga jashtë vendit, ndërhyrjen e anglo-amerikanëve, etj. Pjesëtarë të tjerë të çetës së Kryengritjes së Zhapokikës ishin ish-xhandari Bajram Ahmetaj, ish-funksionari Meh-

met Yzeiri, polici Salo Kalo, bujku Sefer Yzeiri, bujku Safet Kamberi, ish-majori Sulo Zaimi, etj. Lëvizja u zhvillua në zonat e Mallakastrës, Gjirokastrës e Beratit, ku arritën të grumbulloheshin 25 persona të armatosur. Më 20 shtator 1948 ata formuan çetën “Baba Shefqet”, në nder të klerikut bektashi të pushkatuar nga komunistët më 14 janar 1948. Flamuri i çetës ishte flamuri kombëtar pa yllin e kuq, ndërsa kënga e çetës “Kënga e Baba Tomorrit”:

*Ejani o popull, mblihduni me ne,
O baba Tomorr, lësho një rrufe,
Armët ne i kemi fshehur nën dhe,
Do të bëjmë luftë, flakë e batare,
Si luftoi me pallë trimi Skënderbe.*

Më 28 shtator 1948 u zgjodh me votim komanda e çetës: Xhemal Brahimi, komisar politik, Baram Ahmetaj, komandant, Mehmet Yzeiri, nënkomandant, Salo Kaso, anëtar shtabi, Sefer Yzeri, kryetar i skuadrës së atentatorëve.

Çeta mori përsipër të lidhej me grupe të tjera antikomuniste derisa në Shqipëri të krijohet një qeveri nacionaliste demokratike. Shumica e anëtarëve të çetës ishin nga Zhapokika e Luftinja. Duke e konsideruar veten edhe si grupim politik, çeta zhvilloi disa mbledhje. Mbledhjen e parë e bëri në vendin e quajtur Ledhi i Madh, të dytën në malin e Zhapokikës dhe tjetrën në Kamçisht. Formacioni shënoi rritje në numër duke qenë se e zhvillonte veprimtarinë në zona malore ku forcat e ndjekjes të Ministrisë së Brendshme e kishin të vështirë të depërtonin. Më 2 tetor 1948 çeta sulmoi forcat e ndjekjes, pasi këta kishin ndaluar tre antikomunistë. Pas këtij sulmi të çetës forcat qeveritare u tërhoqën. Pasi çau rrethimin në Plashnik e Molisht, çeta mori drejtimin e Beratit, por u godit në Gllavë më 8 tetor 1948. Nga forcat qeveritare u vranë dy persona, ndërsa nga çeta u vranë Mehmet Yzeiri dhe Salo Kaso. Kjo ishte goditja më e rëndë për çetën. Disa anëtarë u dorëzuan, të tjerë u arrestuan apo u arratisën. Shaqo Limja dhe Sefer Yzeri qëndruan më gjatë. Bajram Ahmetaj u arrestua në janar të vitit 1949.

Procesi gjyqësor

Regjimi synoi të bënte një gjykim të shpejtë e shembullor. Gjyqi u zhvillua në Gjykatën Ushtarake të Gjirokastrës. Më datë 14.5.194 trupa gjyquese dha vendimin nr. 24, bazuar në pretendencën e prokurorit ku akuzoheshin se: “...në shtator – tetor 1948 kanë formuar bandë të armatosur për të rrëzuar pushtetin popullor, kanë marrë pjesë në luftime kundër forcave të regjimit, kanë vranë dy policë dhe shefin e seksionit të Sigurimit Xhezo Makashi dhe kanë lidhur e kanë dashur të vrasin dy fshatarë”.

1. Bajram Ahmetaj, 59 vjeç, arrestuar më 4.1.1949, dënuar me vdekje.
2. Sefer Yzeri, 39 vjeç, arrestuar më 10.10.1949, dënuar me vdekje.
3. Shaqo Muçodemaj, 29 vjeç, arrestuar më 16.10.1948, dënuar me 20 vjet burg.
4. Xhemal Asllani, 21 vjeç, arrestuar më 5.10.1948, dënuar me 15 vjet burg.
5. Xhemal Begaj, 35 vjeç, arrestuar më 10.10.1948, dënuar me 12 vjet burg.
6. Mete Didi, vjeç 36, arrestuar më 19.10.1948, dënuar me 15 vjet burg.
7. Balil Veliu, 39 vjeç, arrestuar më 10.10.1948, dënuar me 15 vjet burg.
8. Xhelal Begaj, 35 vjeç, arrestuar më 10.10.1948, dënuar me 12 vjet burg.
9. Gani Kodheli, 36 vjeç, arrestuar më 16.10.1948, dënuar me 12 vjet burg.
10. Mehmet Mupodemaj, 21 vjeç, arrestuar më 5.10.1948, dënuar me 12 vjet burg.
11. Hajri Mahmutaj (Cenometaj), 39 vjeç, arrestuar më 10.10.1948, dënuar me 12 vjet burg.
12. Selfo Xhemali, 49 vjeç, arrestuar më 16.10.1948, dënuar me 4 vjet burg.
13. Beg Veizi, 49 vjeç, arrestuar më 5.10.1948, dënuar me 4 vjet burg.
14. Nuredin Rrodhaj, 29 vjeç, arrestuar më 5.10.1948, dënuar me 4 vjet burg.
15. Hajredin Alushi, 33 vjeç, arrestuar më 16.10.1948, dënuar me 4 vjet burg.

16. Mehmet Kalemaj, 49 vjeç, arrestuar më 16.10.1948, dënuar me 4 vjet burg.
17. Teme Pajo, 49 vjeç, arrestuar më 5.10.1948, dënuar me 3 vjet burg.
18. Shefqet Didi, 19 vjeç, arrestuar më 16.10.1948, dënuar me 3 vjet burg.
19. Seit Çaushaj, 34 vjeç, arrestuar më 10.10.1948, dënuar me 3 vjet burg.
20. Jashar Canaj, 44 vjeç, arrestuar më 10.10.1948, dënuar me 3 vjet burg.
21. Maliq Didi, 57 vjeç, arrestuar më 5.10.1948, dënuar me 2 vjet burg.
22. Demo Aliu, 45 vjeç, arrestuar më 5.10.1948, dënuar me 2 vjet burg.
23. Riza Çaushti, 49 vjeç, arrestuar më 10.10.1948, dënuar me 2 vjet burg.
24. Mufit Islami, 29 vjeç, arrestuar më 5.10.1948, dënuar me 2 vjet burg.
25. Adem Memaj, 21 vjeç, arrestuar më 10.10.1948, dënuar me 12 vjet burg.

Përndjekja dhe transparenca mbi të shkuarën

Një nga veprimtaritë e Autoritetit është hapja e dosjeve/dokumenteve/fashikujve të krijuara nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit, në ngarkim të personave të caktuar kundërshtarë të regjimit diktatorial, apo dosjeve të krijuara për vetë bashkëpunëtorët apo të favorizuarit e ish-Sigurimit të Shtetit.

Në këtë kontekst, për shtetasit Shaqo Lime Muçodemaj, AIDSSH-ja disponon dosje formulare, kategoria 2B, e krijuar nga strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit që në vitin 1959, gjatë kohës së vuajtjes së dënimit në burgun e Burrelit deri në tetor të vitit 1988, që përkon me vdekjen e tij. Po ashtu për shtetasin Hajri Cenometaj, dosje personale, kategoria 2B.

Nga njohja me dokumentacionin arkivor të gjendur në dosjet e sipërcituara të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, vërehet përndjekja permanente, me akuza herë-herë të sajuara, me pyetje sugjestionuese dhe provokime të njëpasnjëshme, me denigrime dhe përbaltje të figurës së tyre deri në ekstrem përpara komunitetit të zonës. Njëherazi vërehet se një numër i konsiderueshëm personash që rezultojnë të vendosur në bashkëpunim me ish-Sigurimin e Shtetit e kanë përmbushur me zell detyrën, për shkak të vetë rrethanave të tyre jetësore, familjare dhe biografike.

Informacioni në dosjet e Sigurimit të Shtetit

AIDSSH-ja mundësoi informacionin mbi përmbajtjen e dosjes formulare të krijuar në ngarkim të shtetasit Shaqo Muçodemaj, nga dokumente autentike të para për herë të parë, për të kuptuar dhe njohur më mirë elementet dhe metodat e përdorura nga strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Shtetasi Shaqo Muçodemaj pas daljes nga burgu në vitin 1967 (kryerjes së dënimit me 18 vite burg) punësohet në sektorin e "derrave", si një nga sektorët më të vështirë në kooperativën e bashkuar Luft-injë, merret në përpunim aktiv 2A nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit. Për ndjekjen dhe survejimin e tij deri në momentin e vdekjes u përdorën tetë bashkëpunëtorë.

Më poshtë jepen disa deklarime të këtij subjekti dhënë bashkëpunëtorëve që e kanë ndjekur sistematikisht apo dëshmitarëve që kanë bërë kallëzime pranë organeve të ish-Sigurimit të Shtetit.

"Çfarë socializmi?! Këta nuk kanë turp që thonë kështu, sepse socializmin nuk e do gjithë bota, por këta kanë ngelur si peshku pa ujë. Socializmi nuk ka për t'u ndërtuar as për 500 vjet."

"Ali Pashë Tepelena preu një rrap të madh në Progonat dhe mblodhi burrat e fshatit dhe tha: - Ne e premë këtë rrap. Një nga burrat u çua dhe i tha: - Ju pretë një, po aty mbijnë 20". Lidhur me këtë thënie u vunë në lëvizje strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit dhe vetë ai, i pyetur nga një bashkëpunëtor, u shpreh se: "Sa më shumë të vrasësh, aq më shumë armiq ke, se po të vrasësh një të shtohen të tjerë".

"Shyqyr që nuk ngordhën qetë e kooperativës se kushedi sa burra do të ishin në burg, sepse këta të fusin në burg me dyshime, sidomos ne që kemi ndonjë kleçkë".

Një nga dëshmitarët deklaronte se, duke qenë në stallat e kooperativës bashkë me

Shaqon, kur aty shkoi kryetari i Këshillit Popullor të Bashkuar Luftinjë, Shaqua ankohet, “se derrat nuk janë mirë, se po të dinë derrat ku janë depot e armëve, do marrin armët dhe do të të vrisnin ty të parin, kryetarin e kooperativës dhe komunistët e tjerë”.

Shaqua në bashkëbisedim me një bashkëpunëtor i thotë se “më parë kishim më shumë për të ngrënë, ndërsa tani nuk kemi çfarë të hamë. Një kg vaj marrim, që është si sh... dhe apo me këtë bukë që është e keqe nuk e ha as qeni dhe të thyen dhëmbët”.

Me thënie të tilla, strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit e denigruan shtetasin Shaqo Muçodemaj përpara anëtarëve të kooperativës së bashkuar Luftinjë, duke arritur kulmin, që folësit në këto mbledhje, mes të tjerave, të shprehen se Shaqua duhej varur në litar, si armik i betuar i regjimit.

Së fundmi, vlen të theksohet se përndjekja dhe survejimi i shtetasit Shaqo Muçodemaj, si element armik i pushtetit popullor, që zhvillon agjitacion e propogandë kundër pushtetit, ka përfunduar me mbylljen e dosjes së përpunimit 2B dhe arkivimin e saj më datë 27.10.1988, datë që përkon edhe me vdekjen e tij.

Për dhënien e këtij informacioni publikut, është punuar kryesisht mbi dosjen hetimore gjyqësore të krijuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, për shtetasin Bajram Kamber Ahmetaj dhe njëzet e tre të dënuarit që morën pjesë në kryengritjen e Zhapokikës të vitit 1948.



Raport mbi këndin e kujtesës për Sabiha Kasimatin në Muzeun e Shkencave të Natyrës "Sabiha Kasimati"

Në ditën e parë të vitit akademik universitar 2018-2019, më 15 tetor, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit përuroi këndin e kujtesës së studiueses Sabiha Kasimati, në Muzeun e Shkencave të Natyrës që tashmë mban emrin e saj.

Aktivitetet u zhvilluan në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, studiues e familjarë.

Fjalën e rastit e mbajtën dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës prof. dr. Spiro Drushku, Rektori i Universitetit të Tiranës, prof. dr. Mynyr Koni, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë znj. Lindita Nikolla, Kryetarja e AIDSSH-së, znj. Gentiana Sula dhe z. Uran Butka, në prani të përfaqësuesve të shumtë të botës akademike, familjarëve, studiuesve, studentëve dhe trupit diplomatik.

Me realizimin e këndit informues në hyrje të Muzeut, Autoriteti përmbushi një nga detyrat e tij, atë

të informimit qytetar përmes kërkimit shkencor në funksion të së vërtetës historike dhe përballjes me të shkuarën. Pas një pune më shumë se njëvjeçare të institucionit, të bashkërenduar me projekte të shkencës, hedhjes dritë mbi të kaluarën dhe ridimensionimit të personaliteteve, u bë e mundur që Sabiha Kasimatit t'i jepet një vend nderi në Muzeun që vetë ajo ideoi, konceptoi, propozoi e themeloi, përpara se të dënohej dhe ekzekutohej brutalisht, për t'u braktisur pastaj në harresën dhjetërvjeçare. Këndi i kujtesës përmban materiale që e prezantojnë Kasimatit si shkencëtare dhe personalitet kurajoz.

Ai është finalizuar nga bashkëpunimi i një grupi ndërdisiplinor me historianë, biologë, arkivistë, gazetarë e kërkues shkencorë, dhe një pjesë e të dhënave ekspozohen për herë të parë. Narrativa e jetës dhe veprimtarisë së Sabiha Kasimatit është bazuar në dokumente, shkresa, raporte e fotografi të rralla; pas propozimit të AIDSSH-së më 8 mars të këtij viti, për t'i dhënë emrin e saj Muzeut të Shkencave të Natyrës, vendimi u miratua unanimisht nga Senati i Universitetit të Tiranës.

Prej disa vjetësh, studiues të shumtë, bazuar në kërkime të shumta arkivore, përmes publikimeve të ndryshme kanë synuar ridimensionimin e figurës së saj për t'i dhënë vendin që i takon në historinë dhe shkencën shqiptare. Presidenti i Republikës e nderoi me medaljen "Për veprimtari patriotike" dhe në kuadrin e grupit të 22 intelektualëve të pushkatuar, si "Nderi i Kombit". Duke i prezantuar këto studime në një institucion arsimor, Autoriteti i njej të rinjtë dhe publikun e interesuar me personalitetin e Kasimatit dhe, përmes dokumenteve e dëshmime, ndihmon në ringritjen e emrit të saj.

Pas fjalës së organizatorëve dhe vizitës në këndin e kujtesës, në mjediset e Muzeut u shfaq filmi dokumentar mbi jetën e Sabiha Kasimatit i gazetarit Ferdinand Dervishi.



Raport mbi ekspozitën "Mbikëqyr! Terrorizo! Përndiq!" e STASI-t (Policia sekrete e ish-Republikës Demokratike Gjermane)

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Fondacionin Konrad Adenauer solli në Shqipëri më 22 tetor 2018 një ekspozitë të rrallë të veprimtarisë së STASI-t në Gjermaninë Lindore, mundësuar nga Autoriteti Gjerman i Hapjes së Dosjeve, BStU. Ekspozita titullohej "Mbikëqyr! Terrorizo! Përndiq!" dhe hapi siparin e aktiviteteve të Ditëve të Kujtesës. Veprimtaria ishte e hapur për mediat.

Materialet e ekspozitës u organizuan në tematika dhe ishin përkthyer në shqip. Ata informuan të interesuarit për strategjitë e survejimit dhe të përndjekjes në Gjermaninë Lindore.

"Shokë, duhet të dimë gjithçka!", ishte motoja që Ministri i Sigurimit të Shtetit, Erih Milke, u jepte punonjësve të tij. "Me këto informacione duhet të zbuloni dhe të bëni të padëmshëm "armiqtë" e Partisë së Bashkuar Socialiste Gjermane, për të siguruar pushtetin e saj në DDR".

Për të përmbushur këtë mision, Ministria e Sigurimit të Shtetit (MfS) kishte kompetenca të zgjeruara: ajo ishte në të njëjtën kohë policia e fshehtë shtetërore, hetuesi dhe shërbimi i zbulimit të jashtëm. Në vitin 1989 STASI kishte rreth 91 000 punonjës, të cilët ndihmoheshin prej rreth 189 000 bashkëpunëtorëve, që jepnin informacione nga të gjitha fushat e jetës.

Ekspozita përmbante të dhëna themelore mbi aktivitetin e MfS-së. E bazuar mbi pesë tematika: rinia, udhëtimet, kultura, kisha dhe sporti – ajo dëshmoi se si STASI e mbikëqyrte dhe kontrollonte jetën e përditshme të popullsisë. Fate individësh të përzgjedhur qartësuan se çfarë do të thoshte për njerëzit e prekur "përpunim" nga STASI, përmes prezantimit të çështjeve specifike operative.

Z. Marenglen Kasmi, anëtar i Autoritetit, u shpreh se "nëpërmjet kësaj ekspozite synojmë jo vetëm të hedhim dritë mbi veprimtarinë e STASI-t, por të tregojmë edhe ngjashmëritë e STASI-t me Sigurimin e Shtetit". Ai iu referua përvojës gjermane si model ballafaqimi të një shoqërie demokratike me të kaluarën diktatoriale të vendit.



Raport mbi konferencën ndërkombëtare shkencore "Të mohuar nga regjimi" - burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri, 1945-1990

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe Institutin për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë më 29 tetor 2018 organizoi në Tiranë konferencën ndërkombëtare shkencore me temë: "Të mohuar nga regjimi: burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri 1945-1990". Veprimtaritë u zhvilluan përgjatë tri ditëve dhe ishin të hapura për mediat.

Më 29 tetor, në orën 18.00, në Muzeun Historik Kombëtar, në sallën UNESCO, u bë prezantimi i të ftuarve dhe mbajtja e fjalës së organizatorëve, në praninë e studiuesve, kërkuesve shkencorë, përfaqësuesve të trupit diplomatik dhe shoqatave të të drejtave të njeriut, të universiteteve të vendit dhe studentëve, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve publike e joqeveritare.

Të ftuar shqiptarë e të huaj dhe personalitete të kërkimit shkencor e institucioneve të kujtesës hapën siparin e kësaj konference të parë që, përmes studimesh cilësore, trajtoi periudhën e diktaturës komuniste në Shqipëri. Perspektivës studimore të profesorëve dhe akademikëve vendas e atyre të Kosovës iu shtua kontributi i ndjeshëm i studiuesve të huaj, si dhe pjesëmarrja aktive e Rrjetit European të Kujtesës (ENRS) e BsTu, Autoritetit Gjerman të Hapjes së Dosjeve.

Në vijim u shfaq filmi "Dyert memece të Ferrit", një rrugëtim nëpër burgjet dhe kampet e punës së detyruar në Shqipëri, i realizuar nga bashkëpunimi i Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe Fondacionit Konrad Adenauer.

Më 30 dhe 31 tetor, nga ora 9.00 deri në orën 17.00, në sallën "Shpataraku", studiues shqiptarë e të huaj, kërkues shkencorë, historianë dhe gazetarë trajtuan për herë të parë temën e internim-dëbimeve në Shqipëri, duke u bazuar në konceptualizimin, historinë dhe praktikën e punës së detyruar gjatë regjimit komunist, përmes një qasjeje historiko-juridike ndaj institucionalizimit të punës së detyruar.

Puna për konferencën kishte nisur prej muajsh dhe thirrjes për pjesëmarrje iu përgjigjën mbi 50 studiues shqiptarë e të huaj. Komisioni i vlerësimit përzgjedhi 36 punime, duke i organizuar në 9 panele me nga 4 studiues, të kërkimit shkencor dhe të kujtesës. Për muaj me radhë, studiuesit e përzgjedhur kanë pasur mundësi të shfrytëzojnë inventarët, dosjet, statistikat dhe materialet e ndryshme arkivore të vëna në dispozicion nga AIDSSH-ja apo të tjera arkiva e, nëpërmjet kërkimit e objektivitetit shkencor, të mundësojnë një panoramë të zgjeruar të punës së detyruar gjatë diktaturës, në aspektin historik, juridik dhe social.

Konferenca ndërkombëtare shkencore u mbështet nga PNUD-i në Shqipëri dhe Qeveria e Italisë, në kuadër të projektit "Përkujtojmë për të shëruar dhe parandaluar", Fondacioni Konrad-Adenauer (KAS), Rrjeti European i Kujtesës dhe Solidaritetit (ENRS) dhe Muzeu Historik Kombëtar.

Mbi punën e detyruar në Shqipëri 1945-1990

Kampet e punës për të burgosurit ishin ndër fenomenet më të dhimbshme të regjimit komunist. Një raport i Departamentit të Shtetit drejtuar Kombeve të Bashkuara në vitin 1955 shprehej me nota shqetësuese për përdorimin e punës së detyrueshme në burgjet dhe kampet e internimit në Shqipëri. Sipas këtij raporti, "puna e detyrueshme përdoret në masë në Shqipëri, që kur regjimi i sotëm komunist erdhi në fuqi, në nëndor 1944. Janë botuar një numër ligjesh dhe vendimesh të cilat legalizojnë punën me përdhunë, dhe Kodi Penal i ri Shqiptar që u adoptua në maj 1952, bazuar në Kodin Penal Sovjetik, bën parashikime me mjeshtëri për "punë korrektonjese" dhe internime qytetarësh në kampe koncentrimi dhe pune. Edhe fëmijët që kanë mbërritur moshën 12 vjeç janë të përgjegjshëm kundrejt masave për në kampet "me punë korrektonjese" t'akuzuar për krime kundër shtetit".

Gjatë 28 viteve që pasuan rënien e regjimit komunist në Shqipëri, komuniteti i studiuesve nuk ka qenë shumë i fokusuar në këto çështje delikate. Në Shqipëri kanë munguar studimet serioze mbi punën e detyruar dhe sistemin e internim-dëbimeve; nuk janë ndërtuar ende vende të kujtesës mbi regjimin komunist; nuk janë zhvilluar aktivitete të mirëfillta shkencore mbi këto problematika dhe vetëm së fundi po bëhet punë sistematike për mbledhjen e dëshmimeve dhe kujtimeve të personave që kanë vuajtur në

burgjet dhe kampet e internimit.





AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETITIT

Adresa
Garda e Republikës, Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë
www.autoritetidosjeve.gov.al



PËR VITIN
2018

Nr. 6
(nëntor-dhjetor 2018)

BULETINI

I VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT
PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

BULETINI

I VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT
PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR VITIN
2018

Përmbajtja

Vendime mbi bazën e kërkesave të institucioneve kushtetuese dhe atyre publike.....	6
Vendim nr. 414, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	7
Vendim nr. 415, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	7
Vendim nr. 419, datë 20.11.2018 (i shkurtuar).....	8
Vendim nr. 444, datë 6.12.2018 (i shkurtuar)	8
Vendime për miratimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione.....	10
Vendim nr. 420, datë 20.11.2018 (i shkurtuar).....	11
Vendim nr. 441, datë 26.11.2018 (i shkurtuar).....	11
Vendime për informim për qëllime kërkimore, historike nga studiues, media.....	12
Vendim nr. 405, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	13
Vendim nr. 406, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	13
Vendim nr. 407, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	14
Vendim nr. 408, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	14
Vendim nr. 409, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	15
Vendim nr. 410, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	15
Vendim nr. 411, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	15
Vendim nr. 412, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	16
Vendim nr. 413, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	17
Vendim nr. 416, datë 16.11.2018 (i shkurtuar).....	17
Vendim nr. 417, datë 16.11.2018 (i shkurtuar).....	18
Vendim nr. 418, datë 16.11.2018 (i shkurtuar).....	18
Vendim nr. 435, datë 26.11.2018 (i shkurtuar).....	19
Vendim nr. 436, datë 26.11.2018 (i shkurtuar).....	19
Vendim nr. 437, datë 26.11.2018 (i shkurtuar).....	20
Vendim nr. 438, datë 26.11.2018 (i shkurtuar).....	20
Vendim nr. 439, datë 26.11.2018 (i shkurtuar).....	20
Vendim nr. 440, datë 26.11.2018 (i shkurtuar).....	21
Vendim nr. 446, datë 18.12.2018 (i shkurtuar)	21
Vendim nr. 447, datë 18.12.2018 (i shkurtuar)	22
Vendime të organizimit të brendshëm të Autoritetit	24
Vendim nr. 448, datë 18.12.2018 (i shkurtuar)	25
Vendime për persona të prekur, palë të treta, të afërm të të vdekurve apo të zhdukurve, bashkëpunëtorëve apo të favorizuarve nga ish-Sigurimi i Shtetit.....	26
Vendim nr. 394, datë 5.11.2018 (i shkurtuar).....	27
Vendim nr. 395, datë 5.11.2018 (i shkurtuar).....	27
Vendim nr. 396, datë 5.11.2018 (i shkurtuar).....	28
Vendim nr. 397, datë 5.11.2018 (i shkurtuar).....	28

Vendim nr. 398, datë 5.11.2018 (i shkurtuar).....	28
Vendim nr. 399, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	29
Vendim nr. 400, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	29
Vendim nr. 401, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	30
Vendim nr. 402, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	30
Vendim nr. 403, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	31
Vendim nr. 404, datë 8.11.2018 (i shkurtuar).....	31
Vendim nr. 421, datë 22.11.2018 (i shkurtuar).....	31
Vendim nr. 422, datë 22.11.2018 (i shkurtuar).....	32
Vendim nr. 423, datë 22.11.2018 (i shkurtuar).....	32
Vendim nr. 424, datë 22.11.2018 (i shkurtuar).....	33
Vendim nr. 425, datë 22.11.2018 (i shkurtuar).....	33
Vendim nr. 426, datë 22.11.2018 (i shkurtuar).....	34
Vendim nr. 427, datë 22.11.2018 (i shkurtuar).....	34
Vendim nr. 428 datë 22.11.2018 (i shkurtuar).....	34
Vendim nr. 429, datë 22.11.2018 (i shkurtuar).....	35
Vendim nr. 430, datë 22.11.2018 (i shkurtuar).....	35
Vendim nr. 431, datë 22.11.2018 (i shkurtuar).....	35
Vendim nr. 432, datë 26.11.2018 (i shkurtuar).....	36
Vendim nr. 433, datë 26.11.2018 (i shkurtuar).....	36
Vendim nr. 434, datë 26.11.2018 (i shkurtuar).....	37
Vendim nr. 442, datë 6.12.2018 (i shkurtuar).....	37
Vendim nr. 443, datë 6.12.2018 (i shkurtuar).....	38
Vendim nr. 445, datë 6.12.2018 (i shkurtuar).....	38

Raporte të aktiviteteve të AIDSSH-së 40

Raport mbi propozimet e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit Kuvendit të Shqipërisë, për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor, në kuadër të reformës zgjedhore 40

Raport mbi vizitën e AIDSSH në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Institucionalizim i marrëveshjeve me Zërin e Amerikës dhe "Federatën Vatra").....49

Raport mbi prezantimin e ekspozitës "Mbikëqyr! Terrorizo! Përndiq!"për të rinjtë e gjimnazeve STASI, policia sekrete e ish-Republikës Demokratike Gjermane dhe paralelet e saj në realitetin shqiptar 50

Raport mbi vizitën e zhvilluar në Rumani, pranë Autoritetit të Dosjeve, C.N.S.A.S..... 50

Raport mbi bashkëpunimin e Autoritetin me Wikipedia-n shqip në lidhje me historinë e komunizmit dhe ish-Sigurimit Të Shtetit 52

**VEN DIME MBI
BAZËN E
KËRKESAVE TË
INSTITUCIONEVE
KUSHTETUESE DHE
ATYRE PUBLIKE**



Vendim nr. 414, datë 8.11.2018 (i shkurtuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", në mbledhjen e datës 8.11.2018, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të informojë institucionin e Gardës së Republikës, për informacionin që kërkohet, me shkresën nr. 2892/1 prot., datë 27.7.2018, sipas objektit të saj, se:
 - a) Për zotin Q. N. P. (P.), nga verifikimet e kryera deri tani, **figuron të ketë materiale në emër të tij**, si fleta e regjistrit të degës IV, ku figuron i regjistruar në regjistrin e agjunkturës model K.I., me numër regjistri 23039, kategoria "R", drejtim objekti, tërhequr në bashkëpunim më datë 7.6.1983, asgjësuar më 15.8.1986, se u pranua anëtar partie, sipas nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".
2. Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet për dijeni Ministrisë së Brendshme.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: **Gentiana Sula**
 Anëtarë: **Altin Hoxha, dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj**

Vendim nr. 415, datë 8.11.2018 (i shkurtuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", në mbledhjen e datës 8.11.2018, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të informojë institucionin e Gardës së Republikës, për informacionin që kërkohet, me shkresën nr. 2892/1 prot., datë 27.7.2018, sipas objektit të saj, se:
 - a) Për zotërinjtë: 1. G. S. S. (S., S.), 2. A. K. N., 3. V. P. D., 4. K. D. Gj., 5. L. D. V., 6. S. F. B., nga verifikimet e kryera deri tani, **nuk figurojnë të ketë materiale** në emër të tyre, sipas 29, pika 2 të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".
2. Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet për dijeni Ministrisë së Brendshme.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: **Gentiana Sula**
 Anëtarë: **Altin Hoxha, dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj**

Vendim nr. 419, datë 20.11.2018 (i shkurtuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", në mbledhjen e datës 20.11.2018, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të informojë institucionin e Avokatit të Popullit për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 381 prot., datë 18.10.2018, "Kërkesë për informacion", mbi bazën e dokumentacionit të administruar nga ana jonë, se për zotin S. K. N.:
 - **figuron të ketë materiale**, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në dosjen personale, fondi nr. 2, si kuadër oficer, dega e ndjekjes së krimeve në përbërje të Drejtorisë së Policisë, si dhe punëtor operativ në rajonin nr. 1, Tiranë, sipas nenit 29, pika 2, germa "c", të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: **Gentiana Sula**

Anëtarë: **Altin Hoxha, dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj**

Vendim nr. 444, datë 6.12.2018 (i shkurtuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", në mbledhjen e datës 6.12.2018, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 64, datë 25.10.2017, të marrë nga Autoriteti, mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga Fakulteti Ekonomik, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në kuadër të vlerësimit të cilëve etike, morale dhe profesionale të shtetasit I. T. K.
2. Ky vendim është i akimueshëm në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarë: **Altin Hoxha, dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj**

**VENDIME PËR
MIRATIMIN E
MARRËVESHJEVE
TË BASHKËPUNIMIT
ME INSTITUCIONE**

Vendim nr. 420, datë 20.11.2018 (i shkurtuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të neneve 1, 8, 17 dhe 35 të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 9.5.2017 të Autoritetit, në mbledhjen e datës 14.11.2018, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Zërit të Amerikës.
2. Nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit nga të dyja palët me qëllim realizimin e objektit të vendosur në Marrëveshje.
3. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: **Gentiana Sula**
Anëtarë: **Altin Hoxha, dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj**

Vendim nr. 441, datë 26.11.2018 (i shkurtuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, neni 17 i rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit”, në mbledhjen e datës 26.11.2018, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Ambasadës Gjermane.
 2. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: **Gentiana Sula**
Anëtarë: **Altin Hoxha, dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj**

**VENDIME PËR
INFORMIM PËR
QËLLIME KËRKIMORE,
HISTORIKE NGA
STUDIUES, MEDIA**



Vendim nr. 405, datë 8.11.2018 (i shkurtuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", në mbledhjen e datës 8.11.2018, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të vendosë në dispozicion të shtetasit Gj. B. dokumentet si më poshtë:
 - Fondi 1, dosje hetimore-gjyqësore nr. 1303/A, në ngarkim të, P. D. K., D. A. M., D. M. H., 24 fletë, (30 faqe të digjitalizuara).
 - Dokumente nga dosje që lidhen me shtetasin D. Sh. K.:
Fondi 1, dosja 2336/A, viti 1971, Gjykata e Rrethit Krujë (36 faqe të digjitalizuara).
 - Fondi 1, dosja 2336 A/I, dosje hetuesie (58 faqe të digjitalizuara).
 - Fondi 1, dosja 2336 A/II, dosje hetuesie (7 faqe të digjitalizuara).
 - Fondi 1, dosja 2336 A/III, dosje hetuesie (25 faqe të digjitalizuara).
 - Fondi 1, dosja 2336 A/IV, dosje hetuesie (27 faqe të digjitalizuara).

Dokumentet janë digjitalizuar dhe anonimizuar (sipas rastit dhe natyrës së dokumenteve), dhe vihen në dispozicion në formë CD.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: **Gentiana Sula**
Anëtarë: **Altin Hoxha, dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj**

Vendim nr. 406, datë 8.11.2018 (i shkurtuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", në mbledhjen e datës 8.11.2018, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të vendosë në dispozicion të shtetasit K. K. dokumentet, si më poshtë:
 - Dokumente lidhur me grupin e studentëve palestinezë, në Historikun e Sigurimit, Drejtoria e Tiranës (në total 2 faqe, fotokopje).

Dokumentet janë digjitalizuar dhe anonimizuar (sipas rastit dhe natyrës së dokumenteve), dhe vihen në dispozicion në formë CD.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: **Gentiana Sula**
Anëtarë: **Altin Hoxha, dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj**

Vendim nr. 407, datë 8.11.2018 (i shkurtuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", në mbledhjen e datës 8.11.2018, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të vendosë në dispozicion të shtetasit E. T. dokumentet, si më poshtë:
 - Dokumente nga dosja formulare nr. 307 II/A, fondi 140, në ngarkim të shtetasit Rr. G. (në total 127 faqe të digjitalizuara).
Dokumentet janë digjitalizuar dhe anonimizuar (sipas rastiit dhe natyrës së dokumenteve), dhe vihen në dispozicion në formë CD.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: **Gentiana Sula**
Anëtarë: **Altin Hoxha, dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj**

Vendim nr. 408 datë 8.11.2018 (i shkurtuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", në mbledhjen e datës 8.11.2018, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të vendosë në dispozicion të shtetasit Gj. B. dokumentet, si më poshtë:
 - VITI 1949, dosje nr. 36 – Materiale të ndryshme mbi monarko-fashistët grekë të përqendruar në kampin e Baliasit dhe në atë të Lushnjës, 3 fletë (4 faqe të digjitalizuara).
 - VITI 1950, dosje nr. 7 – Pasqyra statistikore mbi gjetjen e të burgosurve, kampet mbi ngjarjet kriminale të vjedhjeve dhe mbi komunikacionin për vitet 49-50 (ana e policisë), 11 fletë (12 faqe të digjitalizuara).
 - VITI 1975, dosje nr. 127 – Vendime të komisionit të internim-dëbimeve 84 fletë (84 faqe të digjitalizuara).
 - VITI 1976, dosje nr. 67 - Informacion dërguar Komitetit Qendror të Partisë mbi masat për spastrimin e brezit të zonës kufitare nga elementet me rrezikshmëri shoqërore dhe njoftim i komisionit të internim-dëbimeve mbi internimin e këtyre personave, 9 fletë (10 faqe të digjitalizuara).
 - VITI 1975, dosje nr. 126 - Informacione dërguar udhëheqjes së Partisë së shtetit mbi masën e internimit dhe personat e internuar nga rrethi i Tiranës dhe dislokimi i tyre në rrethe, 14 fletë (15 faqe të digjitalizuara).
 - VITI 1975, dosje nr. 127/1- Informacion për internimet e dëbimet deri në vitin 1975, 11 fletë (12 faqe të digjitalizuara).

1. Të informojë shtetasen M. C., për sa kërkohet në shkresën nr. 333 prot, datë 18.12.2017, ku mbi bazën e verifikimeve të kryera deri tani, **për të ndjerin A. C. ka dokumente** në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit, përkatësisht:
 - Dosje personale (dosje pune) nr. 1453, e përbërë nga 103 (njëqind e tre) faqe që ekzistojnë për subjektin A. C.
2. Për njohjen me përmbajtjen e këtij dokumentacioni nga ana e trashëgimtarëve ka pengesë ligjore.
3. Ky vendim është i akimueshëm në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarë: **Altin Hoxha, dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj**

Vendim nr. 443, datë 6.12.2018 (i shkurtuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", në mbledhjen e datës 6.12.2018, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të informojë shtetasin T. K., për sa kërkohet në shkresën nr. 26 prot, datë 17.3.2017, ku mbi bazën e verifikimeve të kryera deri tani, për të **ka dokumente** në arkivat e ish-Sigurimit të Shtetit përkatësisht:
 - Dosje hetimore-gjyqësore nr. 7960, e përbërë në total nga 1059 faqe, të dixhitalizuara dhe të hedhura në format CD, që ekzistojnë në arkivat e Autoritetit, për subjektin T. K.
2. T'i jepet shtetasit T. K. dokumentacioni dublikat që përmban dosja e emërtuar më sipër, në format CD.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarë: **Altin Hoxha, dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj**

Vendim nr. 445, datë 6.12.2018 (i shkurtuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", në mbledhjen e datës 6.12.2018, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të informojë shtetasin I. M., për sa kërkohet në shkresën 213 prot, datë 16.4.2018, se Autoriteti nuk ka tagrin për bërjen e interpretimit dhe të sqarimit, qoftë edhe teknik, të dokumentacionit veçse sa është shprehur me vendimin nr. 51, datë 1.8.2018.
2. Ky vendim është i akimueshëm në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarë: **Altin Hoxha, dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj**



RAPORTE TË AKTIVITETEVE TË AIDSSH-SË

Raport mbi propozimet e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit Kuvendit të Shqipërisë, për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor, në kuadër të reformës zgjedhore

Në datën 8 nëntor 2018 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) i paraqiti disa propozime konkrete Kuvendit të Shqipërisë, Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore, për disa shtesa dhe ndryshime në dispozitat e Kodit Zgjedhor, që lidhen me pastërtinë e figurave publike që kandidojnë për deputetë ose kryetar bashkie, me qëllim transparencën gjatë fushatave zgjedhore, mbi ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit deri më 2 korrik të vitit 1991.

Në këtë kuadër, Autoriteti kërkoi nga Komisioni i Posaçëm i Reformës Zgjedhore që të marrë në konsideratë propozimin për të bërë disa shtesa apo ndryshime në dispozitat e Kodit Zgjedhor, mbi bazën e informacionit, dijeve dhe eksperiencën teknike të përfutur si eksperiencë nga zgjedhjet e kaluara.

Duke konstatuar dhe vlerësuar problematikën konkrete në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë qershor 2017, ku nga 18 (tetëmbëdhjetë) parti politike të regjistruara në zgjedhje vetëm dy prej tyre paraqitën kërkesë në Autoritet për verifikimin e figurës së pastërtisë të kandidatëve të propozuar nga ana e tyre (PDIU, PAP), Autoriteti u deklarua i gatshëm të ofrojë të gjithë kontributin apo asistencën e duhur për ndryshimet ligjore të mundshme në Kodin Zgjedhor, lidhur me çdo kërkesë të paraqitur nga subjektet e regjistruara në zgjedhjet e radhës, për qëllime të transparencës së figurës së kandidatëve, gjatë fushatave elektorale dhe më gjerë.

Sa më sipër, Autoriteti, në mbledhjen e tij të radhës, pasi shqyrtoi disa propozime për shtesa në Kodin Zgjedhor, të paraqitura nga administrata e tij, përgatiti një draft/propozim për përmirësime të nevojshme të kuadrit ligjor zgjedhor, të cilat i paraqiti Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore me besimin se do t'i materializojë në dispozita të reja ligjore.

Mbështetur në punën e vet për verifikimin e figurave publike sipas kërkesës, Autoriteti parashtroi si më poshtë propozimet e detajuara dhe të arsyetuara.

Në respekt të informimit të qytetarëve, një ndër shtyllat e organizimit të institucionit, duke synuar transparencë, besueshmëri dhe kandidatë me figurë të pastër morale në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato vendore, paraqet propozimet e mëposhtme:

PROPOZIME

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN nr. 10 019, DATË 29.12.2008 “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

VARIANTI 1

Verifikimi paraprak i figurave të pastërtisë së kandidatëve për t'u zgjedhur deputet dhe kryetar bashkie, sipas ligjit nr. 45/2015, para afatit kohor të regjistrimit të subjekteve zgjedhore në kqz (jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve).

Neni 64

Të shtohen pikat 3, 4 dhe 5, me këtë përmbajtje:

“3. Çdo parti politike ka të drejtë që të paraqesë në KQZ, jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve:

- a) kërkesë për verifikim paraprak të kandidaturave të mundshme të saj, për deputet apo kryetarë të bashkive sipas zgjedhjeve të radhës, me qëllim vlerësimin e ekzistencës së rrethanave, sipas nenit 30 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- b) kërkesa e partisë politike përkatës, e cila përmban gjeneralitetet e subjektit zgjedhor, duhet të jetë e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati i mundshëm për t'u zgjedhur.

4. KQZ, me disponimin e kërkesës së paraqitur nga partia politike përkatëse, së bashku me formularët tip të aplikimit të plotësuar nga vetë kandidatët e mundshëm për t'u zgjedhur, menjëherë e dërgon atë pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti), për të kryer procedurat e vlerësimit të figurës së pastërtisë së kandidatëve, në lidhje me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit.

5. Autoriteti, me administrimin e çdo kërkesë të paraqitur nga çdo parti politike, së bashku me formularët tip të aplikimit të plotësuar nga vetë kandidatët e mundshëm për t'u zgjedhur, si dhe pas shqyrtimit të çdo kërkesë të dërguar nga ana e KQZ-së, do të shprehet me vendim për rezultatet e verifikimit rast pas rasti, të cilat do t'ia përcjellë KQZ dhe vetë partisë politike përkatëse mundësisht para afatit kohor të dorëzimit të dokumenteve të kandidimit në KQZ apo KZAZ sipas rasti, por jo më vonë se 10 ditë para përfundimit të fushatës zgjedhore.”.

Neni 69

Pas pikës 4 të nenit 69 të shtohen pikat 5 dhe 6, me këtë përmbajtje:

“4. Komiteti nismëtar i krijuar për paraqitjen e një kandidati nga zgjedhësit, për zgjedhjet për deputet në Kuvend, jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve, i lind e drejta që t'i paraqesë KQZ-së:

- a) kërkesë për verifikim paraprak të kandidatit të mundshëm për deputet, me qëllim vlerësimin e ekzistencës së rrethanave, sipas nenit 30 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- b) kërkesa e komitetit nismëtar, e cila përmban gjeneralitetet e 9 zgjedhësve nga zona zgjedhore përkatëse, duhet të jetë e shoqëruar me formularin tip të apli-

kimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati i mundshëm për t'u zgjedhur deputet në zonën zgjedhore përkatëse.

5. KQZ, me disponimin e kërkesës së paraqitur nga komiteti nismëtar përkatës, së bashku me formularët tip të aplikimit të plotësuar nga vetë kandidati i mundshëm për t'u zgjedhur deputet në Kuvendin e Shqipërisë, menjëherë e dërgon atë pranë Autoritetit për të kryer procedurat e vlerësimit të figurës së pastërtisë së kandidatit për deputet, në lidhje me ekzistencën për të të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit.

6. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me administrimin e kërkesës së paraqitur nga çdo komitet nismëtar, së bashku me formularët tip të aplikimit të plotësuar nga vetë kandidati i mundshëm për t'u zgjedhur deputet, pas shqyrtimit të saj, do të shprehet me vendim për rezultatet e verifikimit rast pas rasti, të cilat do t'ia përcjellë KQZ-së dhe vetë komitetit nismëtar, mundësisht para afatit kohor të dorëzimit të dokumenteve të kandidimit në KQZ, por jo më vonë se 10 ditë para përfundimit të fushatës zgjedhore.”.

Neni 70

Në pikën 4 të nenit 70 të shtohen pikat 5 dhe 6, me këtë përmbajtje:

“4. Komiteti nismëtar i krijuar për paraqitjen e një kandidati nga zgjedhësit, për kryetar bashkie, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve, i lind e drejta që t'i paraqesë KQZ/KZAA-së:

- a) kërkesë për verifikim paraprak të kandidatit të mundshëm për kryetar bashkie, me qëllim vlerësimin e ekzistencës së rrethanave, sipas nenit 30 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- b) kërkesa e komitetit nismëtar, e cila përmban gjeneralitetet e 9 zgjedhësve nga zona zgjedhore përkatëse, duhet të jetë e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati i mundshëm për t'u zgjedhur kryetar bashkie në zonën zgjedhore përkatëse.

5. KQZ/KZAA, me disponimin e kërkesës së paraqitur nga partia politike përkatëse, së bashku me formularin tip të aplikimit të plotësuar nga vetë kandidatët e mundshëm për t'u zgjedhur, menjëherë e dërgon atë pranë Autoritetit, për të kryer procedurat e vlerësimit të figurës së pastërtisë së kandidatit, në lidhje me ekzistencën për të të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit.

6. Autoriteti, me administrimin e kërkesës të paraqitur nga komiteti nismëtar, së bashku me formularët tip të aplikimit të plotësuar nga vetë kandidati i mundshëm për t'u zgjedhur kryetar bashkie, pas shqyrtimit të kërkesës, do të shprehet me vendim për rezultatet e verifikimit rast pas rasti, të cilin do t'ia përcjellë KQZ/KZAA-së dhe vetë komitetit nismëtar, mundësisht para afatit kohor të dorëzimit të dokumenteve të kandidimit në KZ, por jo më vonë se 10 ditë para përfundimit të fushatës zgjedhore.”.

Neni 72

Në pikën 2, të shtohet germa “dh” pas germës “d”, me këtë përmbajtje:

“dh) Kopje e vendimit të marrë nga Autoriteti, lidhur me ekzistencën e informacioneve

në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, për çdo kandidat për t'u zgjedhur, të propozuar nga subjekti zgjedhor përkatës, për zgjedhjet e radhës.”.

Neni 82

Të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Brenda këtij minutazhi apo atij të përcaktuar në nenin 80 të Kodit Zgjedhor për KQZ-në, kjo e fundit duhet të informojë zgjedhësit, edhe për rezultatin e verifikimit të kryer nga Autoriteti, mbi ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, për çdo kandidat që konkurren në zgjedhjet e radhës, i propozuar nga subjekti zgjedhor përkatës, me qëllim transparencën e figurës së çdo kandidati, gjatë fushatave elektorale.”

VARIANTI 2

Transparencë

Verifikim i figurave të pastërtisë së kandidatëve për t'u zgjedhur deputet apo kryetar bashkie, sipas nenit 30 të ligjit nr. 45/2015, me qëllim transparencën e figurës së kandidatit gjatë fushatave elektorale

Neni 67

1. Në fund të fjalisë së paragrafit të parë të pikës 1 të këtij neni, të shtohet fjalia:

“si dhe kërkesën me gjeneralitetet e partisë politike të regjistruar në zgjedhje, për verifikimin e figurave të kandidatëve për deputet në çdo zonë zgjedhore, e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkurren për t'u zgjedhur deputet në zonën zgjedhore përkatëse.”.

2. Në fund të fjalisë së paragrafit të dytë të pikës 1 të këtij neni, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Partia politike e regjistruar për zgjedhjet e organeve të qeverisjes zgjedhore, depoziton në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore përkatëse, kërkesën për verifikimin e figurës së kandidatit për kryetar bashkie, ku janë të shënuara edhe gjeneralitetet e partisë politike, e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkurren për t'u zgjedhur kryetar bashkie në zonën zgjedhore përkatëse.”.

3. Në fund të fjalisë së paragrafit të parë të pikës 2 të shtohet fjalia:

“si dhe kërkesën për verifikimin e kandidatëve me gjeneralitetet e partisë politike pjesëtare të koalicionit, e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkurren për t'u zgjedhur deputet për çdo zonë zgjedhore.”.

4. Në fund të fjalisë së paragrafit të parë të pikës 3 të këtij neni, të shtohen fjalët me këtë përmbajtje:

“si dhe depoziton në KQZ kërkesën për verifikimin e figurës së kandidatit të saj, ku janë të shënuara edhe gjeneralitetet e partisë politike, e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar

nga vetë kandidati që konkurren për t'u zgjedhur kryetar bashkie në zonën zgjedhore përkatëse.”.

Neni 69

Pas pikës 4 të nenit 69 të shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“Komiteti nismëtar i regjistruar në KQZ për zgjedhjet për Kuvend, jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve, ka detyrimin t'i paraqesë KQZ-së:

- a) kërkesën për verifikimin e figurës së kandidatit për deputet, me qëllim vlerësimin e ekzistencës së rrethanave, sipas nenit 30 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- b) kërkesa e komitetit nismëtar, e cila përmban gjeneralitetet e 9 zgjedhësve nga zona zgjedhore përkatëse, duhet të jetë e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkurren për t'u zgjedhur deputet në zonën zgjedhore përkatëse.”.

Neni 70

Pas pikës 4 të shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“Komiteti nismëtar i regjistruar në KZAA për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve, ka detyrimin t'i paraqesë KKZA-së përkatëse:

- a) kërkesën për verifikimin e figurës së kandidatit për kryetar bashkie, me qëllim vlerësimin e ekzistencës së rrethanave, sipas nenit 30 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- b) kërkesa e komitetit nismëtar, e cila përmban gjeneralitetet e 9 zgjedhësve nga zona zgjedhore përkatëse, duhet të jetë e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkurren për t'u zgjedhur kryetar bashkie në zonën zgjedhore përkatëse.”.

Neni 72

Në pikën 2, pas germës “d” të shtohet germa “dh”, me këtë përmbajtje:

“(dh) deklarimin e kandidatit dhe nënshkrimin e tij në një formular vetëdeklarimi, ku duhet të deklarojë mosekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit për të, sipas parashikimeve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 30 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Neni 73

1. Në pikën 2, në fund të fjalisë, të shtohet fjalia si më poshtë:

“Mosparaqitja e kërkesës për verifikimin e figurës së kandidatëve për t'u zgjedhur deputet apo kryetar bashkie nga çdo subjekt zgjedhor, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, e shoqëruar kjo me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkurren për t'u zgjedhur deputet apo kryetar bashkie në zonën zgjedhore përkatëse, sipas zgjedhjeve të radhës, përbën shkak për marrjen e vendimit për refuzimin e dokumentacionit përfundimtar.”.

2. Të shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

“KQZ-ja ose, sipas rastit, KZAZ-ja, me disponimin e kërkesës së paraqitur nga çdo subjekt zgjedhor, për verifikimin e figurës së kandidatëve që konkurrojnë për deputet apo për kryetar bashkie, e shoqëruar me formularin tip të aplikimit të plotësuar nga vetë kandidatët për t’u zgjedhur, menjëherë e dërgon atë pranë Autoritetit, për të kryer procedurat e vlerësimit të figurës së pastërtisë së çdo kandidati, në lidhje me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit.

6. Autoriteti, me administrimin e kërkesës të dërguar nga KQZ/KZAZ, e shoqëruar me formularët tip të aplikimit të plotësuar nga vetë kandidati për t’u zgjedhur deputet apo kryetar bashkie, pas shqyrtimit të kërkesës, do të shprehet me vendim për rezultatet e verifikimit, lidhur me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, të cilin do t’ia përcjellë KQZ/KZAZ-së dhe vetë subjektit zgjedhor kërkues, jo më vonë se 10 ditë para përfundimit të fushatës zgjedhore.”.

Neni 82

Të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“KQZ-ja, brenda këtij minutazhi apo atij të përcaktuar në nenin 80 të Kodit Zgjedhor, me qëllim transparencën e figurës gjatë fushatave elektorale të çdo kandidati që konkurron për t’u zgjedhur deputet apo kryetar bashkie:

a) Së pari, duhet të informojë zgjedhësit, për rezultatin e verifikimit të kryer nga Autoriteti, mbi ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, për çdo kandidat që konkurron në zgjedhjet e radhës, i propozuar nga subjekti zgjedhor përkatës;

b) Së dyti, duhet të publikojë në media dhe në faqen zyrtare të saj në internet, vendimet e Autoritetit mbi rezultatet e verifikimit të figurës së pastërtisë të çdo kandidati për t’u zgjedhur objekt verifikimi.”.

VARIANTI 3

Me kusht ndalues

Verifikim i figurave të pastërtisë së kandidatëve për t’u zgjedhur deputet apo kryetar bashkie, sipas nenit 30 të ligjit nr. 45/2015, në lidhje me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-sigurimit të shtetit

Neni 67

1. Në pikën 1, në fund të fjalisë së paragrafit të parë të shtohet fjalia:

“si dhe kërkesën me gjeneralitetet e partisë politike të regjistruar në zgjedhje, për verifikimin e figurave të kandidatëve për deputet në çdo zonë zgjedhore, e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkurron për t’u zgjedhur deputet në zonën zgjedhore përkatëse.”.

2. Në pikën 2, në fund të fjalisë së paragrafit të dytë të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Partia politike e regjistruar për zgjedhjet e organeve të qeverisjes zgjedhore, depoziton në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore përkatëse, kërkesën për verifikimin e figurës së kandidatit për kryetar bashkie, ku janë të shënuara edhe gjeneralitetet e partisë politike, e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkurron

për t'u zgjedhur kryetar bashkie në zonën zgjedhore përkatëse.”.

3. Në pikën 2, në fund të fjalisë së paragrafit të parë të shtohet fjalia:

“si dhe kërkesën për verifikimin e kandidatëve me gjeneralitetet e partisë politike pjesëtare të koalicionit, e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkurren për t'u zgjedhur deputet për çdo zonë zgjedhore.”.

4. Në pikën 3, në fund të fjalisë së paragrafit të parë, të shtohet fjalët, me këtë përmbajtje:

“si dhe depoziton në KQZ kërkesën për verifikimin e figurës së kandidatit të saj, ku janë të shënuara edhe gjeneralitetet e partisë politike, e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkurren për t'u zgjedhur kryetar bashkie në zonën zgjedhore përkatëse.”.

Neni 69

Pas pikës 4 të nenit 69 të shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“Komiteti nismëtar i regjistruar në KQZ për zgjedhjet për Kuvend, jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve, ka detyrimin t'i paraqesë KQZ-së:

- a) kërkesën për verifikimin e figurës së kandidatit për deputet, me qëllim vlerësimin e ekzistencës së rrethanave, sipas nenit 30 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- b) kërkesa e komitetit nismëtar, e cila përmban gjeneralitetet e 9 zgjedhësve nga zona zgjedhore përkatëse, duhet të jetë e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkurren për t'u zgjedhur deputet në zonën zgjedhore përkatëse.”.

Neni 70

Pas pikës 4 të shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“Komiteti nismëtar i regjistruar në KZAA, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve, ka detyrimin t'i paraqesë KZAA-së përkatëse:

- a) kërkesën për verifikimin e figurës së kandidatit për kryetar bashkie, me qëllim vlerësimin e ekzistencës së rrethanave, sipas nenit 30 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- b) kërkesa e komitetit nismëtar, e cila përmban gjeneralitetet e 9 zgjedhësve nga zona zgjedhore përkatëse, duhet të jetë e shoqëruar me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe

i nënshkruar nga vetë kandidati që konkurren për t'u zgjedhur kryetar bashkie në zonën zgjedhore përkatëse.”.

Neni 72

Pas pikës 2, germa “d” të këtij neni, të shtohet germa “dh”, me këtë përmbajtje:

“dh) deklarimin e kandidatit dhe nënshkrimin e tij në një formular vetëdeklarimi, ku duhet të deklarojë mosekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit për të, sipas parashikimeve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 30 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.”.

Neni 73

1. Në pikën 2, në fund të fjalisë, të shtohet fjalia si më poshtë:

“Mosparaqitja e kërkesës për verifikimin e figurës së kandidatëve për t'u zgjedhur deputet apo kryetar bashkie nga çdo subjekt zgjedhor, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, e shoqëruar kjo me formularin tip të aplikimit për institucionet, sipas modelit të miratuar nga Autoriteti, i plotësuar dhe i nënshkruar nga vetë kandidati që konkurren për t'u zgjedhur deputet apo kryetar bashkie në zonën zgjedhore përkatëse, sipas zgjedhjeve të radhës, përbën shkak për marrjen e vendimit për refuzimin e dokumentacionit përfundimtar.”.

2. Të shtohet pika 7 në nenin 73, me këtë përmbajtje:

“KQZ-ja ose, sipas rastit KZAZ-ja, me disponimin e kërkesës së paraqitur nga çdo subjekt zgjedhor, për verifikimin e figurës së kandidatëve që konkurrojnë për deputet apo për kryetar bashkie, e shoqëruar me formularin tip të aplikimit të plotësuar nga vetë kandidatët për t'u zgjedhur, menjëherë e dërgon atë pranë Autoritetit, për të kryer procedurat e vlerësimit të figurës së pastërtisë së çdo kandidati, në lidhje me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit.

6. Autoriteti, me administrimin e kërkesës të dërguar nga KQZ/KZAZ, e shoqëruar me formularët tip të aplikimit të plotësuar nga vetë kandidati për t'u zgjedhur deputet apo kryetar bashkie, pas shqyrtimit të kërkesës, verifikimit të plotë, do të shprehet me vendim për rezultatet e verifikimit, lidhur me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, të cilin menjëherë ia përcjell KQZ-së dhe vetë subjektit zgjedhor kërkues, por jo më vonë se dy muaj pas disponimit të kërkesës.”.

3. Pas nenit 73 të shtohet neni 73/1, me këtë përmbajtje:

“Veprimet e KQZ-së, në rastin kur për kandidatin për t'u zgjedhur deputet apo kryetar bashkie, figurojnë të këtë informacione në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas pikës 2 të nenit 30 të ligjit nr. 45/2015.

1. Kur KQZ-ja njihet me vendimmarrjen e Autoritetit për kandidatin që konkurren për t'u zgjedhur deputet apo kryetar bashkie dhe për të cilin ekzistojnë informacione në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 30 të ligjit nr. 45/2015, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) Heq emrin e kandidatit para procesit të shtypjes së fletëve të votimit dhe në rastin e kandidatit për kryetar bashkie nuk e zëvendëson atë, kur informacionin e disponon para kryerjes së këtij procesi;
- b) Shpall pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore përkatëse, kur kandidati ka të drejtën e mandatit të kryetarit të bashkisë, mbi bazën e votave të marra, si dhe faktin e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë së kandidatit përkatës, kur informacionin e disponon pas shtypjes së fletëve të votimit dhe para shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve;

- c) Shpall fitues nga lista shumemërore kandidatin vijues në renditje dhe në përputhje me kuotën gjinore, si dhe shpall faktin e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë për kandidatin përkatës, kur informacionin e disponon pas shtypjes së fletëve të votimit dhe para shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve;
- d) Shpall pavlefshmërinë e mandatit ndaj personit i shpallur i zgjedhur në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, si dhe shpall mandatin, në përputhje me Kodin Zgjedhor, kur informacionin e disponon pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.”.

Neni 82

Të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“KQZ-ja, brenda këtij minutazhi, duhet:

- a) së pari, të informojë zgjedhësit, për rezultatit e verifikimit të kryer nga Autoriteti, mbi ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, për çdo kandidat që konkurren në zgjedhjet e radhës, i propozuar nga subjekti zgjedhor përkatës;



- b) së dyti, të publikojë në media dhe në faqen zyrtare të saj në internet, vendimet e Autoritetit mbi rezultatet e verifikimit të figurës së pastërtisë të çdo kandidati për t'u zgjedhur objekt verifikimi.”.

Raport mbi vizitën e AIDSSH në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Institucionalizim i marrëveshjeve me Zërin e Amerikës dhe "Federatën Vatra")

Në datat 28 nëntor deri në 3 dhjetor 2018 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit zhvilloi një vizitë pune në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me ftesë të Federatës Panshqiptare "Vatra", në vijim të bashkëpunimeve me komunitetet brenda dhe jashtë vendit. Veprimtaritë u zhvilluan të hapura për publikun.

Autoriteti zhvilloi aktivitete me fokus kujtesën që në krijim të tij, duke u përqendruar në specifikat e bashkësisë ku është organizuar veprimtaria. Ekipi i vizitës në Amerikë bashkëpunoi me komunitetin shqiptar atje për: organizimin e takimeve mbi kujtesën kolektive, nisur nga hapja e dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit; realizimin të projekteve të përbashkëta që u diskutuan me shqiptarët atje; projektin e dëshmime gojore (që sapo finalizoi botimin e parë) duke e zgjeruar ndjeshëm hartën e tij me dëshmi të mbijetuarve të diktaturës që sot jetojnë në SHBA.

Veç komunikimit të drejtpërdrejtë me bashkësinë shqiptare në Amerikë dhe ofrimin të shërbimeve në bashkëpunim me Federatën Vatra, me qëllim lehtësimin e procedurave të aplikimit nëpërmjet asistimit të të interesuarit, Vizita e AIDSSH në Nju-Jork dhe Uashington kulmoi me firmosjen e dy marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë organizohet dhe funksionon në zbatim të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Socialiste Popullore të Shqipërisë". Si organ i lartë shtetëror i pavarur, në bazë dhe në zbatim të dispozitave të veçanta të ligjit nr. 45/2015, AIDSSH e vë memorien historike në themel të identitetit dhe trashëgimisë së individëve e bashkësive, duke inkurajuar dialog shoqëror pa komplekse për diktaturën, në emër të së vërtetës, pajtimit, lirisë dhe demokracisë.

Në këtë kuadër, AIDSSH arriti firmosjen e marrëveshjes së bashkëpunimit me Zërin e Amerikës për zgjerimin e projektit të dëshmime gojore, duke e pasuruar ndjeshëm arkivin digjital të institucionit. Intervistat gojore të dëshmitarëve që u japin zë viktimitave ruhen sipas parametrave në Autoritet, krahas dosjeve të Sigurimit, instrumente të pushtetit komunist.

Në simpoziumin e organizuar nga "Federata Vatra", veç prezantimit të projektit të dëshmime gojore dhe punës për muzealizimin e kampit të Tepelenës, të konkretizuar në botimin e parë të librit të dëshmime dhe në mbjelljen e pemëve të memorialit të fëmijëve që humbën jetën atje, u shfaq filmi që e dokumenton këtë rrugëtim dhe u shpërndanë publikimet përkatëse.

Autoriteti dhe "Vatra" institucionalizuan bashkëpunimin mes tyre me firmosjen e një marrëveshjeje të zgjeruar bashkëpunimi. Në vijim u prezantua puna e AIDSSH-së për hedhjen dritë në të shkuarën, duke hapur dosjet e përfaqësuesve të emigracionit shqiptar, si dhe duke paraqitur shërbimet e institucionit, fizike dhe ato online. Në mbyllje, të pranishmit patën mundësi të plotësonin formularët e aplikimit për marrjen përgjigje për rastet individuale.

Ndërkohë, bashkëpunimet e AIDSSH-së me komunitetin shqiptar në SHBA dhe arkivat në këtë vend do të vijojnë, me fokus krijimin e kuadrit të plotë historik, social e politik të periudhës së komunizmit të Shqipëri, duke thelluar kërkimin shkencor dhe duke zgjeruar mundësitë e studimit në arkivat përkatëse të kësaj periudhe, brenda dhe jashtë vendit.

Autoriteti e mbështet punën e vet dhe vijimësinë e projekteve të ndërmarra në parimet e rëndësishme të kujtesës, që e vënë memorien historike në themel të identitetit dhe trashëgimisë së individëve e bashkësive, si paraqitja e këndvështrimeve të ndryshme; evitimi i shprehjeve deterministe: shmangia e përgjithësimeve; trajtimi i figurave historike si individë; sigurimi i një baze gjenuine historike; përdorimi i njohurive të nivelit akademik si burime, ku çdo përmbajtje duhet të ballafaqohet e të diskutohet me akademikë të njohur dhe të certifikuar për njohuritë specifike e të duhura për këtë punë.

Mbështetur në këto parime, në kërkimin shkencor dhe përballjen profesionale të fakteve, Autoriteti vijon të ndërmarrë projekte ambicioze e komplekse, që kanë në fokus rishqyrtimin e historisë, rivlerësimin e saj, rehabilitimin e viktimitave, rezistencën e personaliteteve e komuniteteve dhe inkurajojnë dialogun social, në emër të transparencës dhe konsolidimit të demokracisë.

Raport mbi prezantimin e ekspozitës "Mbikëqyr! Terrorizo! Përndiq!" për të rinjtë e gjimnazeve STASI, policia sekrete e ish-Republikës Demokratike Gjermane dhe paralelet e saj në realitetin shqiptar

Më 7 dhjetor 2018, në Tiranë, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Inner Wheel Club Tirana, mundësoi për gjimnazet e Tiranës ekspozitën në lidhje me veprimtarinë e STASI-t në Gjermaninë Lindore, realizuar me Autoritetin Gjerman të Hapjes së Dosjeve, BStU.

Ekspozita titullohej "Mbikëqyr! Terrorizo! Përndiq!" dhe u zhvillua në kuadër të edukimit qytetar, një ndër shtyllat e veprimtarisë së institucionit. Veç prezantimit të ekspozitës për të rinjtë e shkollës së mesme "Petro Nini Luarasi", aktiviteti vijoi me bashkëbisedimin me një të mbijetuar të përndjekjes, ish-i dënuar i burgut të Burrelit, Saimir Maloku. Aktiviteti u zhvillua i hapur për mediat.

Materialet e ekspozitës u organizuan në tematika të përkthyer në shqip. Ata informuan të interesuarit për strategjitë e survejimit dhe të përndjekjes në Gjermaninë Lindore, duke ofruar paralele të qarta me realitetin shqiptar.

"Shokë, duhet të dimë gjithçka!" ishte motoja që Ministri i Sigurimit të Shtetit, Erih Milke, u jepte punonjësve të tij. "Me këto informacione duhet të zbuloni dhe të bëni të padëmshëm "armiqtë" e Partisë së Bashkuar Socialiste Gjermane, për të siguruar pushtetin e saj në DDR".

Për të përmbushur këtë mision, Ministria e Sigurimit të Shtetit (MfS) kishte kompetenca të zgjeruara: ajo ishte në të njëjtën kohë policia e fshehtë shtetërore, hetuesi dhe shërbimi i zbulimit të jashtëm. Në vitin 1989 STASI kishte rreth 91.000 punonjës, që ndihmoheshin prej rreth 189.000 bashkëpunëtorëve, të cilët jepnin informacione nga të gjitha fushat e jetës.

Ekspozita përmbante të dhëna themelore mbi aktivitetin e MfS-së. E bazuar mbi pesë tematika: rinia, udhëtimet, kultura, kisha dhe sporti – ajo tregon se si STASI mbikëqyrte dhe kontrollonte jetën e përditshme të popullsisë. Fate individësh të përzgjedhur qartësuan se çfarë do të thoshte për njerëzit e prekur "përpunim" nga STASI, përmes prezantimit të çështjeve specifike operative.

Marenglen Kasmi, anëtar i Autoritetit, u shpreh se "nëpërmjet kësaj ekspozite jo vetëm hedhim dritë mbi veprimtarinë e STASI-t, por tregojmë edhe ngjashmëritë e STASI-t me Sigurimin e Shtetit". Ai iu referua përvojës gjermane si model ballafaqimi të një shoqërie demokratike me të kaluarën diktatoriale të vendit.

Raport mbi vizitën e zhvilluar në Rumani, pranë Autoritetit të Dosjeve, C.N.S.A.S

Nga data 10 deri më 14 dhjetor 2018, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me autoritetin homolog në Rumani, organizuan një vizitë me qëllim shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet palëve. Një ekip i AIDSSH-së, i kryesuar nga anëtari i Autoritetit, z. Altin Hoxha, e zhvilluan këtë vizitë me ftesë të institucionit homolog rumun sipas një programi të dakordësuar nga të dyja palët.

Në datën 11.12.2018 vizita filloi me një takim në ambientet e arkivit të institucionit për Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në Rumani. Të shoqëruar nga një ish-anëtar i Autoritetit Rumun, dhe koordinatori e vizitës, pjesëmarrësit u njohën me organizimin e arkivit, përpunimin e dokumenteve dhe dosjeve me bar-kode, mënyrën e kalimit të dokumenteve nga institucionet e tjera në arkivin e Autoritetit, mënyrën e kërkimit të dokumenteve, mënyrën e hyrjes në arkiv (arkivi ruhej me forca sigurie), mënyrën e qarkullimit të dokumenteve nga arkivi qendror në arkivin transit, që ishte në godinën kryesore. Në tryezën e rrumbullakët që u organizua më pas, anëtari i Autoritetit, z. Hoxha, gjeti rastin të falënderojë në emër Autoritetit dhe të Kryetares së Autoritetit për këtë mundësi, si dhe bëri një përshkrim të shkurtër mbi mënyrën e funksionimit të AIDSSH-së, duke u ndalur veçanërisht tek arkivi.

Vizita vazhdoi më 12.12.2018 me takimin në drejtorin e arkivit, në godinën qendrore të Autoritetit. Drejtori iu përgjigj një pjese të pyetjeve që pjesëtarët e grupit të Autoritetit Shqiptar kishin bërë një ditë më parë. Drejtori shoqëroi grupin në ambientet e arkivit transit që ishte në katin e nëndheshëm të godinës. Ai prezantoi një mënyrë shumë praktike të bashkëpunimit me Drejtoritë e Investigimit (analoge e Dre-

jtorisë së Informacionit) dhe drejtoritë e tjera përsa i përket procesit administrativ. Veç dosjeve fizike, u bë njohja edhe me mikrofilmat dhe disqet në të cilat ruheshin dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Megjithëse edhe në Rumani ka patur asgjësime dokumentesh, përgjithësisht dokumentet arkivore nuk ishin prekur, fakt ky që e bënte më të lehtë punën e arkivit, por edhe më të shpejta përgjigjet institucionale. Më pas u vizitua zyra e digjitalizimit dhe e studimit të dokumenteve. Ishte e



thjeshtë dhe praktike. Pas Drejtorisë së Arkivit u bë një vizitë në Drejtorinë e Investigimit, ku Drejtori shpjegoi në mënyrë të detajuar strukturën dhe mënyrën e funksionimit të Drejtorisë. Edhe pas këtij takimi u organizua një tryezë e rrumbullakët me drejtorët kryesorë: Drejtori i Përgjithshëm, Drejtori Investigimit, Drejtori i Arkivit, Drejtori i Kërkimit Shkencor, Drejtori i Medias dhe Publikimeve, Drejtori Komunikimit, Drejtori i Teknologjisë së Informacionit etj. Pasi u vu në dispozicion struktura e organizimit të institucionit, Drejtori i Përgjithshëm përshkroi shkurtimisht mënyrën e funksionimit të Autoritetit rumun, raportet me Kolegjin (anëtarët e Autoritetit) dhe raportet me institucionet e tjera. Pasuan pyetjet e grupit shqiptar të Autoritetit në lidhje me problematikat e punës.

Në ditën e tretë të vizitës, jashtë programit, një përfaqësi e delegacionit takoi jashtë programit kryetarin e Kolegjit Z. Constantin Buchet, nënkryetarin dhe anëtarët.

Kryetari i Kolegjit mbajti një fjalë shumë miqësore, ku veçoi gatishmërinë e institucionit rumun për mbështetje të institucionit tonë në të gjitha drejtimet. Si njohës i kulturës shqiptare ai propozoi shkëmbime informacionesh në mënyrë reciproke. Ishin të gatshëm t'i tregonin palës shqiptare gabimet që kishin bërë në të kaluarën me qëllim që të shmangeshin. Tregoi rëndësinë e këtij misioni, kështu e quajti ai punën e Autoritetit, për ndërtimin e demokracive në të dyja vendet. Shprehu dëshirën për të vizituar Tiranën dhe institucionin e Autoritetit në Tiranë. I ftoi të gjithë kolegët rumunë të ndanin eksperiencat e tyre dhe t'u përgjigjeshin pyetjeve të ekipit shqiptar. Kolegji (Autoriteti) rumun u ftua të merrte pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe u hodh ideja e një marrëveshjeje bashkëpunimi në të ardhmen. Kryetari i Kolegjit shprehu dakordësinë për marrëveshjen, draftet e së cilës mund të përgatiten nga stafet teknike. Solli në vëmendje personalitete të shquara shqiptare që kanë jetuar në Rumani dhe që për ta ka dosje nga sigurimi, si dhe tregoi interes për njohje të figurës së Ismail Kadaresë, kërkesë e cila u premtua se do të konkretizohej në vijim nga Drejtoria e Mbështetjes Shkencore.

Takimi përfundoi me një foto të përbashkët.

Raport mbi bashkëpunimin e Autoritetin me Wikipedia-n shqip në lidhje me historinë e komunizmit dhe ish-Sigurimit Të Shtetit

Në datën 19 dhjetor 2018 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në bashkëpunim me komunitetin "Wikimedians of Albanian Language User Group" organizoi në ambientet e AIDSSH (pranë Gardës së Republikës së Shqipërisë, rr. Ibrahim Rugova, Tiranë), aktivitetin "Historia e komunizmit dhe ish-Sigurimit të Shtetit" në Wikipedian shqip.

Ky aktivitet erdhi si rezultat i bashkëpunimit të frytshëm midis dy institucioneve dhe u zhvillua në kuadër të edukimit qytetar, një ndër shtyllat e veprimtarisë së institucionit.

Wikipedia është enciklopedia më e madhe online në botë. Ndaj qëllimi i këtij aktiviteti është pasurimi i Wikipedias në gjuhën shqipe për çështje që lidhen me historinë e komunizmit dhe ish-Sigurimit të Shtetit (1944-1991).

Fjalën e hapjes dhe përshëndetjen e mbajti kryetarja e AIDSSH-së, znj. Gentiana Sula. Ak-



tivitetin e përshëndeti edhe përfaqësuesi i Kombeve të Bashkuara në Tiranë, z. Brian Williams dhe zv/ambasadori i Prezencës së OSBE-së.

Trajnerë të këtij workshop-i ishin znj. Kristina Millona, gazetare dhe z. Kevin Jasini, përfaqësues i Wikimedias shqip. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin rreth 20 të rinj, studentë të profileve të ndryshme, kryesisht histori dhe teknologji informacioni, të interesuar rreth shkrimit të historisë së të shkuarës, si dhe të tjerë të ftuar ndër të cilët edhe partnerë të AIDSSH-së dhe studiues.

Ky workshop u konkretizua me punimin e mbi 15 artikujve të përmirësuar dhe 3 artikujve të rinj të hapur mbi burime të digjitalizuara nga AIDSSH. Në fund të aktivitetit, z. Marenglen Kasmi, anëtar i AIDSSH-së, shpërndau, në shenjë mirënjohjeje ndaj të rinjve, certifikatat e pjesëmarrjes.

Për më shumë informacion rreth materialeve që do të editohen gjatë aktivitetit, vizitoni faqen:

https://sq.wikipedia.org/wiki/wikipedia:wiki_edit-a-thon/_Komunizmi_n%C3%AB_Shqip%C3%AB





AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHËTETIT

Adresa
Garda e Republikës, Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë
www.autoritetidosjeve.gov.al